



UNIVERSITETI  
**BARLETI**

UNIVERSITETI BARLETI

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM PERIODIK

**Programi i Studimit me Karakter Profesional “Teknik në  
Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje”**

### Grupi i Vlerësimit të Brendshëm:

1. Dr. Blerina Banushi (Kryetar)
2. Dr. Doris Doda (Anëtare)
3. Dr. Rezart Prifti (Anëtar)
4. Dr. Edvin Stefani (Anëtar)
5. Klaudio Vila (Student)

SHKURT 2024



## SHKURTIME

ASCAL	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
BNJ	Burime Njerëzore
DESF	Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës
FEQD	Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë
GVB	Grupi i Vlerësimit të Brendshëm
IAL	Institucion i Arsimit të Lartë
Institucion	Universiteti Barleti
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sporteve
NJZHKC	Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë
Programi i studimit	Programi i Studimit me Karakter Profesional “Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje”
RVB	Raporti i Vlerësimit të Brendshëm për Akreditimin e Programit
RSH	Republika e Shqipërisë
TOBMSH	Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje
UniBa	Universiteti Barleti
V.K.M	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZKA	Zyra e Karrierës dhe Alumni
ZMBNJ	Zyra për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

---

Blendi  
Faqe 2



## PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

### Përshkrim përmbledhës

Universiteti “Barleti” (UniBa) ka nisur veprimtarinë e tij akademike në vitin 2005 si institucion jo publik i arsimit të lartë bazuar në VKM Nr. 571, datë 12/08/2005, dhe ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin nr. 80 të vitit 2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”, me Statutin dhe Rregulloren e tij, si dhe në aktet rregullatore për aspekte specifike të UniBa. Që nga koha e hapjes së tij, UniBa punon për të krijuar një profil të qëndrueshëm, dinamik me programe cilësore, bashkëkohore që gërshetojnë akademinë me kërkimin shkencor dhe aplikativ sipas kërkesave gjithmonë në rritje dhe në ndryshim të tregut të punës dhe sfidave të zhvillimit. UniBa synon të bëhet një institucion inovativ dhe lider, digjital, aplikativ dhe praktik, ndërveprues dhe komunitar, i orientuar nga tregu i punës, duke vendosur studentin në qendër dhe duke zhvilluar bashkëpunime rajonale dhe ndërkombëtare.

Në vitin 2020, UniBa ristrukturohet në Universitet me Urdhrin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 213, datë 03.07.2020 për Riorganizimin Institucional të SHLUJ “Universiteti Marin Barleti”, në Universiteti “Barleti” [Evidenca A.1.2.2, Urdhër i MASR për Riorganizimin Institucional të SHLUJ “Universiteti Marin Barleti” në Universiteti “Barleti”].

Me hapjen e fakultetit të katërt të “Shkencave Mjekësore” që mund të aksesohet edhe në faqen zyrtare<sup>1</sup> të Universitetit ka ndryshuar edhe organigrama e Universitetit Barleti [Evidenca A.1.2, Organigrama e UniBa].

UniBa ofron programin e studimit me karakter profesional “Teknik në operacione biznesi, marketing dhe shitje” (TOBMSH), i cili është hapur për herë të parë me shkresën përcjellëse me Nr. 9438, datë 12.09.2018, të Urdhërit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), Nr. 568, datë 12.09.2018 [Evidenca A.3.1. Licensimi i programit TOBMSH me Urdhër 568, datë 12.9.2018] dhe ka marrë akreditimin e parë me 2 vjet me Vendim të Bordit të Akreditimit, Nr. 54, datë 09.09.2022 [Evidenca A.3.2. Akreditimi për herë të parë me Vendim të Bordit të Akreditimit, Nr. 54, datë 09.09.2022] dhe paraqitet sërish për riakreditim.

Programi i studimit ofrohet nga njësi bazë Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës (DESF) që funksionon brenda njësisë kryesore Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë (FEQD), i krijuar në datë 12.04.2006, me Vendimin Nr. 2365 Prot., në të cilin Ministria e Arsimit dhe Shkencës miratoi hapjen e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit dhe Fakultetit të Shkencave Humane duke u ofruar dhe gjashtë programe të reja.

Ky program studimi është i regjistruar si një program me karakter profesional, Niveli 5 i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe përfshihet në fushën kryesore “Shkenca Sociale”, i cili ofrohet në gjuhën shqipe, në formë studimi me kohë të plotë, me kohë normale 2 (dy) vite akademike dhe i ndarë në 4 (katër) semestra. Në përfundim të këtij programi studimi, pasi studenti ka fituar 120 ECTS, ai pajiset me diplomë profesionale “Teknik në operacione biznesi, marketing dhe shitje” në Fakultetin e Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë, në UniBa, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve [Evidenca A.3.7, Format i diplomës TOBMSH], [Evidenca A.3.7.1, Urdhëri i MAS] dhe [Evidenca A.3.7.2, Vërtetim nga QSHA për dokumentin që shoqëron diplomën].

Programi i studimit TOBMSH është i organizuar sipas veprimtarive formuese të klasifikuara nga VKM Nr. 41, datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL dhe VKM Nr. 185, datë 25.03.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL, i ndryshuar”.

<sup>1</sup> <https://umb.edu.al/fakultetet-dhe-qendra.html>



Në përfundim të studimeve studenti krijon një profil profesional e kulturor, për t'iu përgjigjur nevojave kombëtare e rajonale në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë shqiptare në ndryshim dhe zhvillim të vazhdueshëm *[Evidenca A.2.1.1, Mendimi i Dekanit]*.

Realizimi i objektivave, strukturimi dhe përmbajtja e planit mësimor të programit të studimit ndihmojnë dhe garantojnë përfitim nga ana e studentëve të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e tyre në një treg global e dinamik në vazhdimësi. Në përfundim të studimeve, studenti krijon një profil profesional dhe kulturor:

- me një gamë të plotë aftësish njohëse dhe praktike që nevojiten për të gjetur zgjidhje krijuese për probleme në fushën e biznesit dhe marketingut;
- për kryerjen e aktiviteteve komplekse në fushën e studimit;
- për demonstrimin e aftësive për planifikim, organizim dhe kontroll të veprimtarive të punës;
- me aftësi për kontroll dhe mbështetje për personelin, duke siguruar shpjegime ose udhëzues për të realizuar një veprimtari specifike në fushën e studimit.

Programi i studimit ofrohet nga personel akademik i kualifikuar, zhvillohet në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar dhe me infrastrukturë moderne që përmbush më së miri standardet dhe kërkesat e studentëve *[Evidenca A.2.1.1, Mendimi i Dekanit]*.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM**

Procesi i vlerësimit të brendshëm për programin e studimit me karakter profesional “Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje” konsiderohet mjaft i rëndësishëm për institucionin dhe njësitë përbërëse të tij. Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë në UniBA ka aplikuar për ri-akreditimin e programit nëpërmjet sistemit AMS.

Vlerësimi i brendshëm i programit u realizua në përputhje me procedurat e miratuara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë të Arsimit të Lartë të Shqipërisë, udhëzuesit për “*Administrimin e dokumentacionit në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit*”, si dhe bazuar në manualin “*Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit*” të kësaj agjencie, pjesë e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë.

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për programin e studimit me karakter profesional “Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje” (TOBMSH) është ngritur me Urdhër të Rektorit të UniBa, nr. 48, dt. 08.01.2024. *[Evidenca A.2.1.2, Urdhër i Rektorit Nr.48, datë 08.01.2024 “Për ngritjen e GVB” dhe ndryshime]*.

Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë (NjZhKC) në takimin e zhvilluar i përcolli GVB-së, kërkesat që duhet të realizonte dhe bazën ligjore mbi të cilin do të përgatitej raporti i vlerësimit të brendshëm (RVB) dhe dokumentacioni shoqërues.

Grupi i vlerësimit të brendshëm bazuar në udhëzimet për vlerësimin, ka organizuar punën dhe ka bërë të qarta detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e secilit anëtar, duke synuar gjithë përfshirjen e strukturave të fakultetit dhe universitetit. Procesi është koordinuar në respekt të afateve dhe axhendës dërguar nga ASCAL, në bashkëpunim me koordinatoren institucionale të UniBA, dhe është vlerësuar sipas standardeve të miratuara nga ASCAL *[Evidenca A.2.1.3, Plan pune Grupi i Vlerësimit të Brendshëm]*.



Grupi u njoh me dokumentacionin që duhet të përgatisnin, me kriteret që duhet të ndiqnin për realizimin e RVB dhe të dokumentave shoqëruese, si dhe me procedurën që duhet të zbatonin për të mbledhur dhe përgatitur dosjen e vlerësimit, duke i dhënë rëndësi çdo elementi të saj,

Për shkak të karakterit gjithëpërfshirës të rubrikave të RVB-së, përveç anëtarëve të GVB-së në këtë proces, u përfshinë si bashkëpunëtorë përfaqësues të shumë strukturave të UniBA-së. GVB hartoi një plan pune, të detajuar me detyrat dhe udhëzimet përkatëse për mënyrën e plotësimit të informacionit, afatet dhe realizimin e tyre. Gjithashtu, GVB për programin e studimit TOBMSH bëri paraprakisht një ndarje pune sipas standarteve.

GVB-ja iu drejtua zyrtarisht drejtuesve të njësive përgjegjëse për përgatitjen e dokumentave, u njoh me bazën e legjislacionit për vlerësimin e programit TOBMSH dhe më pas filloi punën për shkrimin e RVB-së. GVB ka zhvilluar takime të rregullta, për të identifikuar problematikën, për të parë ecurinë dhe për të vijuar më tej me përmbylljen e detyrës së marrë përsipër. Në mënyrë periodike GVB ka zhvilluar takim me dekanin e FEQD, përgjegjës të departamentit DESF dhe drejtues të njësive të tjera për të bashkëpunuar për realizimin e plotë të dosjes së vlerësimit. Kryetari i GVB ka zhvilluar periodikisht takime konsultative me NjZHKC dhe drejtuesit e UniBa në lidhje me qartësimin dhe plotësimin e kërkesave ligjore e institucionale që kërkohen për përgatitjen e dosjes së vlerësimit.

Për hartimin e raportit GVB u mbështet në këto drejtime kryesore:

- 1) analizën e standardeve dhe nxjerrjen e dokumentacionit dhe informacioneve të kërkuara,
- 2) mbledhjen e të dhënave nga njësia përgjegjëse që ofron programin e studimit si dhe nga strukturat e tjera të UniBA,
- 3) hartimin e draft raportit, shqyrtimin e tij me organet drejtuese, personelin akademik dhe studentët si dhe miratimin e versionit final të këtij raporti që i vihet në dispozicion Grupit të Vlerësimit të Jashtëm.

Mbështetur në dokumentacionin e plotë të përcjellë nga njësitet përgjegjëse, GVB përmbylli plotësisht përgatitjen e tabelave dhe përgatiti evidencat, duke formatuar në këtë mënyrë të gjithë bazën e nevojshme të të dhënave për shkrimin e RVB-së sipas standardeve dhe kriterëve ligjore që i referohen programit TOBMSH. Në përfundim të punës, pas konsulencës me NjZHKC, GVB përgatiti dosjen e vlerësimit të programit TOBMSH dhe e dorëzoi të plotë e të rregullt te NjZHKC.

Procesi i Vlerësimit të Brendshëm nga GVB mbaron në datë 22/02/2024 kur njësia/ departamenti dorëzon dosjen e plotë fizike për akreditimin e programit si edhe kopjen elektronike të dokumentacionit përkatës.





## SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

### I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 54, datë 09.09.2022

Programi i studimit me karakter profesional "Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje" është akredituar për herë të parë me Vendim të Bordit të Akreditimit, Nr. 54, datë 09.09.2022 Për sa më sipër Bordi Akreditimit dha vlerësim pozitiv për akreditim me dy vite, duke rekomanduar:

1. Institucioni, të rishikojë kurrikulën e programit të studimit duke e përshtatur atë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
2. Institucioni, të rishikojë kurrikulën e këtij program studimi, duke e bërë atë më të përshtatshme për këtë program studimit, si dhe ta pasurojë atë me koncepte e lëndë, të përmendura në Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.
3. Institucioni, të rishikojë syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi, në drejtim të:
  - i. përputhjes së objektivave të shprehura në syllabuse me qëllimin e këtij programi studimi si dhe me nivelin e të nxëniet të studentëve të këtij programi studimit;
  - ii. shmangies së përsëritjes së temave të përfshira në syllabuset e programit të studimit;
  - iii. përditësimit të literaturës së përfshirë në syllabuset e programit të studimit.
4. Institucioni, të hartojë një studim të mirëfilltë të tregut të punës dhe të rishikojë kompetencat e synuara të këtij programi, në përputhje me nevojat e tregut.
5. Institucioni të përdorë një sistem të brendshëm për menaxhimin e informacionit, në funksion të këtij programi studimi.
6. Institucioni, të marrë masa për të rritur qëndrueshmërinë e personelit akademik dhe atij administrativ, të angazhuar në këtë program studimi.
7. Institucioni, të marrë masa për përmirësimin e procedurave në raport me kodifikimin e provimeve dhe administrimin e komponentëve të vlerësimit nga sekretaria mësimore.

*[Evidenca A.3.2, Akreditimi për herë të parë me Vendim të Bordit të Akreditimit, Nr. 54, datë 09.09.2022]*

### II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

*Institucioni, të rishikojë kurrikulën e programit të studimit duke e përshtatur atë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.*

Duke ju referuar rekomandimeve të bordit të akreditimit të ASCAL, DESF ka marrë masa për t'ia përshtatur kurrikulën e këtij programi studimi VKM Nr.185, datë 25.03.2021, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar, duke shtuar orët e praktikës profesionale, provimin e formimit dhe ndarjen sipas veprimtarive formuese të këtij vendimi.

*[Evidenca A.3.4. Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)]*



*Institucioni, të rishikojë kurrikulën e këtij program studimi, duke e bërë atë më të përshtatshme për këtë program studimit, si dhe ta pasurojë atë me koncepte e lëndë, të përmendura në Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.*

Duke ju referuar rekomandimeve të bordit të akreditimit të ASCAL, DESF ka marrë masa që kurríkula e këtij program studimi të jetë me lëndë sa më praktike që i përshtaten këtij profili. Në ndryshimin e bërë këtij plani mësimor në masën 20% janë shtuar lëndët “Etika e Biznesit”, “Bazat e Menaxhimit”, janë ndryshuar kreditet tek trajnimet praktike dhe është shtuar provimi përfundimtar.

**[Evidenca A.3.4. Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)]**

*Institucioni, të rishikojë syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi, në drejtim të:*

- iv. *përputhjes së objektivave të shprehura në syllabuse me qëllimin e këtij programi studimi si dhe me nivelin e të nxënít të studentëve të këtij programi studimit;*
- v. *shmangies së përsëritjes së temave të përfshira në syllabuset e programit të studimit;*
- vi. *përditësimin të literaturës së përfshirë në syllabuset e programit të studimit.*

Duke ju referuar rekomandimeve të bordit të akreditimit të ASCAL, stafi akademik në funksion të këtij programi studimi ka realizuar ndryshimin e programeve lëndore (syllabuseve) në drejtim të:

- i. Objektivat e këtyre lëndëve u realizuan që të jenë në funksion të nxënies së studentëve dhe në aplikimin praktik të njohurive të marra prej tyre, duke qenë sa më pranë anës praktike profesionale dhe sa më pranë nevojave të tregut të punës;
- ii. Shmangia e përsëritjes së temave të caktuara për t’ia përshtatur sa më mirë nivelit të studentëve të këtij program, duke i dhënë njohuri dhe kompetenca të përshtatshme për asimilimin sa më të mirë të njohurive praktike;
- iii. Procedura e çdo fillim viti në departament është rishikimi i syllabuseve për përditësimin e literaturës në funksion të pasurimit me informacion dhe tema të reja në funksion të anës praktike të këtij programi profesional.

**[Evidenca A.3.10, Programet Lëndore të programit të studimit]**

*Institucioni, të hartojë një studim të mirëfilltë të tregut të punës dhe të rishikojë kompetencat e synuara të këtij programi, në përputhje me nevojat e tregut.*

Departamenti ka realizuar një studim të mirëfilltë të tregut të punës duke u nisur nga statistikat, raportet dhe dinamikat socio-ekonomike.

**[Evidenca A.3.3, Studimi periodik i tregut të punës TOBMSH]**

*Institucioni të përdorë një sistem të brendshëm për menaxhimin e informacionit, në funksion të këtij programi studimi.*

Institucioni ka aktualisht një portal studentit në të cilin studentët mund të aksesojnë notat e vendosura nga sekretaria. Në funksion të përmirësimit të tij, Institucioni ka marrë masa që së shpejti të vihet në dispozicion të studentëve, stafit akademik dhe administrativ një sistem i brendshëm për menaxhimin e informacionit në lidhje me leksionet, lëndët, notat dhe çdo aktivitet tjetër që duhet të jenë në dijeni studentët. Zyra e TIK-ut ka realizuar një udhëzues brenda të cilit ndodhet edhe sistemi i brendshëm për menaxhimin e informacionit.



*[Evidenca A.1.34, Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së teknologjisë së informacionit UniBa]*

*Institucioni, të marrë masa për të rritur qëndrueshmërinë e personelit akademik dhe atij administrativ, të angazhuar në këtë program studimi.*

Duke ju referuar rekomandimeve të bordit të akreditimit të ASCAL, Institucioni ka marrë masa për të ruajtur qëndrueshmërinë e stafit akademik me kohë të plotë dhe atij administrativ të angazhuar në këtë program studimit.

*[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB]*

*[Evidenca A.1.6.1. Prot.1044 datë 1.10.2023, Dërgohet lista e stafit akademik me kohë të plotë për Vitin Akademik 2023-2024]*

*Institucioni, të marrë masa për përmirësimin e procedurave në raport me kodifikimin e provimeve dhe administrimin e komponentëve të vlerësimit nga sekretaria mësimore.*

Në zbatim të rekomandimeve të bordit të akreditimit të sipërcituara në pikën 7, Institucioni ka marrë masa për përmirësimin e procedurave të kodifikimit të provimeve, duke respektuar Rregulloren e UniBa, ref. Neni 88 “Forma e Kontrollit” dhe aktet e brendshme rregullatore UniBa.

*[Evidenca A.1.3, Rregullore UniBa]*

*[Evidenca A.3.13, Vendim Rektorati, Nr. 94 dt. 12.02.2021 “Për miratimin e formatit të provimeve, etj”]*





**Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional në “Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje”**


**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi L1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Institucioni i arsimit të lartë krenohet me ofrimin e programeve të studimit të hartuara me përpikëri për të përafuar dhe mbështetur interesat kombëtare, duke ruajtur dhe konsoliduar njëkohësisht vlerat akademike dhe kulturore. Çdo program është projektuar me kujdes për të kultivuar një kuptim dhe vlerësim të thellë të zhvillimit dinamik kombëtar social-ekonomik dhe arritjeve akademike. Nëpërmjet kurrikulave rigoroze akademike dhe metodave novatore të mësimdhënies, studentët pajisen me njohuritë, aftësitë dhe vlerat e nevojshme për të kontribuar në mënyrë kuptimplotë në shoqëri duke qëndruar të rrënjësuar në identitetin e tyre kombëtar. Duke theksuar qasjet ndërdisiplinore dhe të menduarit kritik, ky program nxit rritjen intelektuale dhe kultivon ndjenjën e përgjegjësisë ndaj zhvillimit dhe prosperitetit të vendit. Duke i mëshuar një komuniteti studiuesish të përkushtuar për avancimin e interesave kombëtare dhe ruajtjen e vlerave kombëtare, institucioni luan një rol kryesor në formimin e liderëve të ardhshëm, ekspertëve, dhe specialistëve që janë të përkushtuar t'i shërbejnë vendit të tyre me integritet dhe dallim.</p> <p><i>[Evidenca A.1.1, Statuti UniBa]</i> <i>[Evidenca A.1.3, Rregullore UniBa]</i> <i>[Evidenca A.2.1, Rregullore FEQD]</i> <i>[Evidenca A.2.2, Rregullore e DESF]</i> <i>[Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH]</i> <i>[Evidenca A.1.4, Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030]</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>UniBa ka hartuar “Strategjinë e zhvillimit insitucional për periudhën 2020-2030”, në konsulencë të gjerë me stafin e brendshëm, drejtuesit strategjik të UniBa, ekspertëve të jashtëm, dhe përfaqësues të sipërmarrjes partnerë të universitetit. Zbatimi i saj gjen mbështetje të plotë në programet e të gjitha cikleve që ofrohen, ku përmes shtyllës akademike synohet kryerja me efikasitet i procesit të mësimdhënies, me qëllim pajisjen e studentëve me dije bashkëkohore në fushën e marketingut, publicitetit dhe marrëdhënieve me publikun, nën udhëheqjen e një stafi akademik të përgatitur dhe cilësor. Si natyrë aplikative e universitetit Barleti dhe objektivit të përgatitjes së të rinjve jo detyrimisht për vazhdimësi akademike, por profesionale, dhe programi TOBMSH targeton pikërisht këtë segment tregu të edukimit profesional.</p> <p>Programi i studimit Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje (TOBMSH) ofrohet nga Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës (DESF), në Fakultetin e Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë (FEQD), në përputhje të plotë të strategjisë insitucionale <i>[Evidenca A.1.4, Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030, fq. 7]</i>.</p> <p>Programi synon të kontribuojë në rritjen e standardeve të fushës së shitjeve</p>



	<p>dhe marketingut në biznes dhe në përgatitjen e të rinjve me aftësi të larta për një treg që është gjithmonë e në rritje.</p> <p>Programi profesional "TOBMSH" synon të kontribuojë në përmirësimin e standardeve, cilësisë dhe rritjen e vlerës së shtuar në shërbimet që ofrohen në biznes. Programi i studimit TOBMSH është organizuar si program me karakter profesional 2-vjecar, në respektim dhe zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe ofrohet në përputhje me rregullat dhe parimet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë, si dhe fushën e veprimtarisë.</p> <p><i>[Evidenca A.1.18, Manuali i hartimit, riorganizimit, mbylljes dhe vlerësimit të programeve të studimit]</i></p> <p>Departamenti i Finances, Ekonomise dhe Siper marrjes, nëpërmjet këtij programi, synon krijimin e një mjedisi profesional e bashkëkohor për studentët, duke krijuar kurrikula cilësore dhe punësuar si staf akademik profesionistë, të aftë dhe të motivuar në përcjelljen e dijeve dhe përditësimin e studentëve me të rejat e fundit në zhvillimin e ekonomisë së njohurive. Për të konsoliduar vlerat tona akademike dhe kulturore kombëtare, departamenti angazhohet fuqimisht në sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, zhvillimin e veprimtarive kërkimore shkencore dhe inovative, në respektimin e lirisë së shprehjes, diversitetit dhe integritetit për stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, që angazhohet në këtë program studimi.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>UniBa funksionon mbështetur mbi Statutin e institucionit, miratuar nga MASR me Urdhër nr. 360, dt. 23.12.2020 <i>[Evidenca A.1.1, Statuti UniBa]</i> dhe në Rregulloren Akademike <i>[Evidenca A.1.3, Rregullore UniBa]</i>, të cilat azhurohen në mënyrë të vazhdueshme për të krijuar përshtatshmëri me zhvillimet dinamike të mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm.</p> <p>Statuti përcakton qartë drejtimet strategjike të institucionit me synim edukimin ndërdisiplinor të individëve të angazhuar <i>[Evidenca A.1.1, Statuti, neni 5]</i>, respektimin e lirisë akademike në procesin mësimor <i>[Evidenca A.1.1, Statuti, neni 3, pika 2]</i> dhe shtyllat kryesore të aktivitetit akademik përmes strukturës dhe ofertës akademike <i>[Evidenca A.1.1, Statuti, neni 6]</i>.</p> <p>Rregullorja akademike e institucionit përcakton qartë drejtimet prioritare akademike përmes hartimit të rregullave kryesore të organizimit dhe funksionimit të procesit mësimor. <i>[Evidenca A.1.3, Rregullore e UniBa, neni 2]</i>.</p> <p>Të dy këto dokumenta themeltar të normimit të aktivitetit insitucional shërbejnë si bazë për zbatimin e programit të studimit TOBMSH në përputhje të plotë me bazën rregullative të UniBa.</p> <p>Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit TOBMSH janë ndërtuar në përputhje të plotë me një nga fushat e drejtimit akademik dhe të kërkim-zhvillimit të UniBa: Ekonomi, Biznes-Turizëm-Evente <i>[Evidenca A.1.4, Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2023, fq. 11]</i>. Kapacitet e institucionit në këtë fushë janë të larta dhe profesionale, gjë e cila mundëson mbështetje për hartimin, zbatimin dhe përmirësimin e kurikulës.</p> <p>Përmbajtja e programit është hartuar për të ndërtuar kompetenca profesionale te studentët, në kuadër të formimit ndërdisiplinor të tyre në fushën e biznesit, marketingut dhe shitjeve, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimin e dijeve bashkëkohore <i>[Evidenca A.1.4, Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2023, fq. 10]</i>.</p>

*[Handwritten signatures and marks]*



	<p>Programi TOBMSH ofrohet në përputhje të plotë të fushave dhe drejtimeve akademike të njësisë kryesore (Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë) dhe të njësisë bazë (Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>UniBa përpara se të hapte programin TOBMSH zhvilloi konsultime e takime me specialistë marketingu dhe menaxhimi, gjatë të cilave dolën në pah nevoja dhe kërkesa në rritje për marketerë dhe menaxherë profesionistë. Studimet me karakter profesional në programin TOBMSH synojnë kualifikimin e studentëve dhe rritjen e kompetencave të tyre për ushtrimin e menaxhimit dhe mbikqyrjes në kontekstin e aktiviteteve të punës aty ku ka ndryshim të paparashikueshëm rrethanash [Evidenca A.3.1, <i>Licensimi i programit TOBMSH me Urdhër 568, dt. 12.9.2018</i>].</p> <p>Ky program i është nënshtruar një azhormimi të gjerë të kurikulës për të ndjekur kërkesat e kohës dhe dinamikat zhvillimore socio ekonomike. Si rezultat janë rishikuar silabet e të gjitha lëndëve, dhe ndryshuar kurikulat. Këto ndryshim përpos analizës së tregut dhe konsultave me partnerë të cilët ofrojnë praktikën profesionale të të diplomuarve, kanë ardhë dhe si rezultat i reflektimit nga analiza e brendshme e stafit pedagogjik.</p> <p>Duke ndjekur nevojat e tregut të punës, veçanërisht kërkesa për vende e pozicione pune konstatohet që bizneset kërkojnë të punonjësonë individë për pozicione të tilla si: menaxher shitjesh, marketier apo agjent marketingu. Po kështu, një sërë studimesh tregu në vende të ndryshme për profesionet që parashikohen se do të kërkojnë në vitet e ardhshme rezultojnë të lidhura ngushtë me funksionet e marketingut dhe kjo, jo vetëm në Shqipëri. Trendet demografike dhe zhvillimet sociale kanë krijuar hapsira në treg për këtë format studimi. Këtu vlen të përmendet, ashtu si në azhornimin e studimit të tregut theksohet, se 1/3 e 20 vjecarëve nuk janë as në shkollë e as në punë. [Evidenca A.3.5, <i>Studimi periodik i tregut të punës TOBMSH</i>]</p> <p>Pas diplomimit, studentët kanë mundësi të punësohen në biznese të ndryshme në fushën e shitjeve dhe marketingut, pranë ndërmarrjeve dhe institucioneve të ndryshme të angazhuara në këtë industri si brenda dhe jashtë vendit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Ndërtim i planit mësimor të programit TOBMSH është realizuar në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë nr. 80/2015, neni 6 pika 25, neni 70 pika 1 dhe neni 72 pika 1, si dhe të V.K.M. Nr. 41, dt. 24.01.2018 "Per elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", VKM 879/ 2019 dhe VKM 185/ 2021.</p> <p>Plani mësimor i programit të studimit në TOBMSH është i organizuar në 2 vite akademikë dhe 4 semestra, me lëndë e module të vlerësuar me kredite. Gjithsej në planin mësimor janë 4 gruplëndësh, 10 lëndë me 20 module ku përfshihen edhe Trajnimi Praktik.</p> <p>Çdo modul ka të përcaktuar tipin e veprimtarisë, numrin e krediteve sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), ngarkesën totale në orë, ngarkesat javore dhe orët individuale [Evidenca A.3.12, <i>Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 9</i>].</p> <p>Programi i studimit TOBMSH ka në përbërjen e tij lëndë me emërtime e ngarkesa dhe në një raport të drejtë mes teorisë dhe praktikës në përputhje të plotë të qëllimit të programit. Kjo strukturë programi është ndërtuar mbi bazën e programeve dhe përvojave në programe të ngjashme kombëtare e ndërkombëtare dhe lëndët/modulet e tij përcillen te studentit nga staf i kualifikuar dhe profesionist në fushat përkatëse të këtij programi studimi.</p>



	<i>[Evidenca A.3.11, CV e stafit akademik të programit të studimit].</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane <i>[Evidenca A.1.31, Prot. 431 (Dt. 27.03.2023) MAS - Dërgohet përgjigja për Kodifikimin e programeve].</i></p> <p>Ndërtim i planit mësimor të programit TOBMSH është realizuar në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë nr. 80/2015 <i>[Ligji i Arsimit të Lartë nr. 80/2015, neni 6 pika 25, neni 70 pika 1 dhe neni 72 pika 1]</i> dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) “Per elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL-të”.</p> <p>Plani mësimor i programit të studimit në TOBMSH është i organizuar në 2 vite akademikë dhe 4 semestra, me gruplëndësh, lëndë e module të vlerësuar me kredite. Gjithsej në planin mësimor janë 4 gruplëndësh, 10 lëndë me 20 module ku përfshihen edhe Trajnimi Praktik.</p> <p>Çdo modul ka të përcaktuar tipin e veprimtarisë, numrin e krediteve sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), ngarkesën totale në orë, ngarkesat javore dhe orët individuale.</p> <p><i>[Evidenca A.3.4, Plani mësimor për programin e studimit TOBMSH i ndryshuar në masën 20%]</i> <i>[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 9].</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X
<b>Standardi I.2</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, dhe mobilitetit.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>UniBa fillimisht ngriti një grup pune me ekspertë dhe specialitë pjesë e stafit të brendshëm për ri-akreditimin e programit TOBMSH. Ky grup pune u konsultua me ekspertë të jashtëm dhe me kompani që ushtrojnë aktivitetin e tyre në sektorët e marketingut, menaxhimit dhe shitjeve.</p> <p>Kuadri për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit fokusohet në nxitjen e bashkëpunimit të frytshëm brenda institucionit, veçanërisht në kontekstin e një programi studimi profesional akademik. Elementet kryesore të këtij procesi përfshijnë:</p> <p>Ideimi Strategjik, ku kryet një vlerësim i plotë i nevojave për të identifikuar objektivat e programit dhe pritshmëritë e palëve të interesuara.</p> <p>Zhvillimi i një plani strategjik që përshkruan misionin, qëllimet dhe treguesit kryesorë të performancës së programit të cilat janë të integruara me ato departamentale dhe ato institucionale.</p> <p>Ndarja e detyrave dhe përgjegjësive duke përcaktuar qartë rolet dhe përgjegjësitë për njësitë e personelit të përfshirë në program, duke përfshirë stafin akademik, ekipet administrative dhe stafin mbështetës.</p> <p>Në vijimësi krijimi i një ndarje transparente të detyrave për të siguruar që çdo</p>			



	<p>njësi të kontribuojë në mënyrë efektive në suksesin e programit si dhe analiza dhe vlerësimi i vazhdueshëm.</p> <p>Nga departamenti zbatohen vlerësime të rregullta të komponentëve të programit, duke përfshirë kurrikulën, metodologjitë e mësimdhënies dhe proceset administrative. Si dhe integrimi i feedback nga pedagogët, studentët dhe palët e interesuara për të identifikuar fushat për përmirësim dhe inovacion.</p> <p>Komunikimi dhe bashkëpunimi në parim bëhet nëpërmjet nxitjes së kanaleve të hapura të komunikimit ndërmjet njësive të personelit për të lehtësuar bashkëpunimin, si dhe mbledhjeve të rregullta për diskutime, duke siguruar që të gjithë të jenë të informuar dhe në përputhje me objektivat e programit.</p> <p>Zhvillimi profesional është kyc dhe ka të bëjë me investimin në zhvillimin e vazhdueshëm profesional për stafin akademik dhe administrativ për të qëndruar aktual me trendet e industrisë dhe përparimet pedagogjike.</p> <p>Në lidhje me programin, dhe jo vetëm, institucioni ka vënë në vend mekanizma sigurimi të cilësisë për të monitoruar ofrimin e përmbajtjes akademike, shërbimet mbështetëse të studentëve dhe efektivitetin e përgjithshëm të programit [Evidenca A.1.28, Plan Pune NJZHKC 2023-2024].</p> <p>Filozofia bazë ka qenë qasja me në qendër studentin duke i dhënë përparësi suksesit të studentëve duke ofruar shërbime mbështetëse gjithëpërfshirëse, këshillim akademik dhe mundësi për angazhimin e studentëve.</p> <p>Duke zbatuar këtë kuadër, institucioni ka mundur të krijojë një mjedis koheziv dhe bashkëpunues që mbështet hartimin, mbikëqyrjen dhe përmirësimin e suksesshëm të programit të studimit profesional akademik, duke nxitur marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi midis të gjithë aktorëve.</p> <p>Programi u azhormua nga departamenti pas një studimi të bërë për situatën ekonomike, por edhe duke u bazuar në përvojën më të mirë të institucioneve të arsimit të lartë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.</p> <p>Pas disa ndryshimeve, programi ka kalur për shqyrtim dhe miratim në Senatin e universitetit. Programi është ndërtuar në përputhje me strategjinë dhe objektivat e Universitetit në tërësi dhe departamentit në veçanti.</p> <p>Përgjegjësinë kryesore për mbarëvajtjen e programit e ka përgjegjësi i departamentit, i cili në bashkëpunim me anëtarët e departamentit monitorojnë dhe vlerësojnë në mënyrë të vazhdueshme të gjithë ecurinë e zhvillimit të programit [Evidenca A.2.2, Rregullore e Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës, neni 5, fq. 2].</p> <p>Përgjegjësi i departamentit organizon mbledhje periodike me anëtarët e departamentit për të trajtuar dhe analizuar problematikat për zbatimin e programeve që ka në ndjekje njësia bazë dhe për të planifikuar aktivitetin e departamentit për periudhën në vazhdimësi.</p> <p>Në fund të vitit akademik, është organizuar mbledhja e departamentit ku prezantohet dhe analizohet raporti final për ecurinë e aktivitetit të departamentit dhe të programit TOBMSH në veçanti, që ka hartuar përgjegjësi i departamentit. Pas shqyrtimit dhe pasqyrimit të ndryshimeve, është miratuar raporti i analizës së aktivitetit të departamentit për vitin akademik 2022-2023 [Evidenca A.2.4, Analiza vjetore e departamentit për vitin akademik, 2022-2023].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi</p>	<p>Në kuadër të realizimit të qëllimit dhe objektivave të programit profesional “Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje”, si dhe aftësimin profesional të studentëve, Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës ka negociuar një sërë marrëveshesh me institucionet homologe</p>



<p>me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj që operojnë në fushën e menaxhimit, marketingut dhe shitjeve, të cilat janë përmblytur me nënshkrimin e marrëveshjeve të shumta të bashkëpunimit [Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 5].</p> <p>Qëllimi i këtyre marrëveshjeve është realizimi i trajnimeve praktike nga ana e studentëve që ndjekin studimet në programin TOBMSH, duke mundësuar përdorimin e kompetencave të fituara në auditor në një kontekst praktik profesional. Komponenti i praktikës synon t'u japë studentëve një përvojë pune në institucione të ndryshme, t'u krijojë mundësi për të vendosur kontakte që mund t'i ndihmojnë ata për punësimin e tyre në të ardhmen.</p> <p>Për programin profesional 2-vjecar "Teknikë në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje" praktika mësimore zhvillohet në të dy semestrat e vitit akademik. Përgjatë dy viteve të fundit akademikë rezultojnë se 13 (trembëdhjetë) studentë të programit profesional në TOBMSH kanë kryer praktikën pranë organizatave/ institucioneve publike/ private, si: "Novus Marketing and Advertising" dhe "Iceberg Communication". Si rezultate të zhvillimit të praktikës veçojmë se studentët kanë pasur mundësi të njihen me secilin prej institucioneve më nga afër, si dhe kanë kuptuar më nga afër se si funksionojnë kanalet e shitjes për secilën prej industrive ku kanë zhvilluar praktikën dhe janë mësuar me detyra të përgjithshme që një punonjës ka në momentin që është në marrëdhënie pune.</p> <p>Më konkretisht, për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, janë nënshkruar 29 marrëveshje bashkëpunimi me marrëveshje bashkëpunimi të reja me institucione publike/ private vendase dhe të huaja, si dhe aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj, si: REMAX Empire (2022), Çelësi Media Group (2022), Iceberg Communication (2022), Dhoma Ekonomike e Gruas (2022), Dhoma e Tregëtisë dhe Industrisë Tiranë (2023), Tobacco Holding Group (2023), British American Tobacco (2023), FIX PRO (2023), NEXT Albania (2023), KNC shpk (2024), Fondacioni "Tradita Popullore" etj. [Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 5].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.</p>	<p>Fokusi i programit TOBMSH është dhënia e njohurive të konsoliduara profesionale dhe aftësive praktike në fushën e marketingut, shitjeve dhe operacioneve të biznesit. Për këtë qëllim, ky program ka kombinuar njohuritë teorike me praktikën mësimore si dhe me mbështetjen akademike, tre komponentë të rëndësishëm me qëllimin për t'i shërbyer krijimit të kushteve për përgatitjen e studentëve për nevojat e tregut të punës. Për arritjen e qëllimit dhe objektivave, plani mësimor i programit është konceptuar dhe organizuar në mënyrë të tillë që të jetë sa më praktik dhe multiaplikativ, duke përgatitur dhe aftësuar studentët për kërkesat dhe standartet që kërkon tregu i punës në vend, rajon dhe më gjerë [Evidenca A.3.6, Strategjia e zhvillimit të programit të studimit, fq. 1].</p> <p>Studenti është i detyruar të ndjek praktikën mësimore të parashikuara në planin mësimor, të cilat u nënshtrohen të gjitha rregullave të vendosura dhe vlerësimeve, njësoj si për të gjitha detyrimet e tjera. Dokumentacioni, procedura dhe afatet parashikohen në Paketën e Praktikës, të miratuar nga Senati Akademik. Praktikën mësimore kryen në institucionet bashkëpunuese dhe nën mbikëqyrjen e një pedagogu të caktuar nga Departamenti, mbi bazën e marrëveshjes së lidhur ndërmjet palëve, modeli i së cilës është pjesë e paketës së praktikës. Nëpërmjet orëve të praktikës studenti zhvillon aftësitë profesionale dhe praktike për t'u përgatitur me cilësitë e nevojshme që i lehtësojnë integrimin në tregun e punës. [Evidenca A.1.7, Paketa e Praktikës]</p>



	<p><i>për programet me karakter profesional, fq. 1).</i></p> <p>Deri më tani, departamenti në emër të UniBa ka nënshkruar 29 marrëveshje bashkëpunimi aktive me organizata dhe institucione të fushës, të cilat synojnë të realizojnë zhvillimin e praktikave profesionale për studentët, me qëllim pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet e përgatitura nga këto organizata [Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 5].</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Bashkëpunimi me partnerët, me kompani dhe institucione që veprojnë në fushat e menaxhimit, marketingut dhe shitjeve mbetet një angazhim i përhershëm i njësisë bazë ku është i përfshirë programi i studimit TOBMSH. Për këtë arsye, departamenti në mënyrë të vazhdueshme, me mbështetjen e plotë të drejtuesve të institucionit, organizon dhe zhvillon takime me drejtues të organizatave në sektorët e sipër cituar, për të zgjeruar gamën e bashkëpunimit dhe për të rritur përfshirjen e aktorëve relevant në përmirësimin e mëtejshëm të programit TOBMSH [Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 5].</p> <p>Në UniBA është praktikë për departamentin të organizojë mbledhje me anëtarët e tij në mënyrë periodike dhe të analizojë arritjet e realizuara nga këto bashkëpunime. Në këtë kontekst, njësia përgjegjëse bazë harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit [Evidenca A.3.9.1. Përfitimi nga marrëveshjet e bashkëpunimit]. Praktikrat mësimore u nënshtrohen të gjitha rregullave të vendosura dhe vlerësimeve, ashtu sikurse për të gjitha detyrimet e tjera. Vitin e ri akademik (2023-24) njësia përgjegjëse do të vijojë me marrëveshje të reja bashkëpunimi me institucione/ organizata vendase dhe të huaja, në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>Zyrat studentore dhe Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës organizojnë vazhdimisht takime me studentët për t'i informuar mbi programin studimit dhe dobinë e tij, në mënyrë që studentët të orientojnë studimet e tyre drejt një punësimi të suksesshëm.</p> <p>Zyra "Alumni Karriera" në bashkëpunim me njësitë e tjera të Grupit Barleti si Barleti Human Capital, Barleti Hub dhe BTTC zhvillojnë aktivitete trajnuese për të afruar dhe përgatitur studentët me tregun e punës [Evidenca Evidenca A.1.33.8, Plani Strategjik Alumni dhe Karriera 2020 - 2025].</p> <p>Për programin e studimit TOBMSH, për vitin akademik 2020-2021, kemi 4 (katër) të diplomuarit e parë dhe rezultojnë se të gjithë janë të punësuar, në vitin 2021-2022 janë diplomuar 8 (tetë) studentë dhe këtë vit akademik kanë filluar studimet në këtë program 12 studentë, të cilët janë në proces studimi [Evidenca A.3.12, Tabela përmbledhëse për RVB] dhe [Evidenca A.3.9.1. Përfitimi nga marrëveshjet e bashkëpunimit].</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X
<p><b>Standardi L3</b></p> <p>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</p>				



Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Struktura Organizative e UniBa-s është në përputhje me ligjin e arsimit të lartë Nr. 80/2015 si për nga organizimi, ashtu edhe nga ndarja e detyrave që përshkruhen në mënyrë të detajuar në statutin e UniBa, rregulloren e institucionit dhe në aktet e tjera rregullatorë. UniBa harton politika dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, kodin e cilësisë dhe praktikat më të mira bashkëkohore. Strukturat kryesore përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UniBa janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë;</li> <li>➤ Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë.</li> </ul> <p>Të dy këto struktura kanë dhe aktet e tyre rregullatore si: 1) Rregulloren e Komisionit të Sigurimit të Standardeve dhe Cilësisë dhe 2) Rregulloren e Njësies së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, organizimi dhe funksionet e të cilave janë të parashikuara edhe në Statutin e institucionit, nenet 10 dhe 28, rregulloren e UniBa, nenet 14 dhe 15.</p> <p>Gjithashtu në nivel institucional është ngritur dhe funksionon edhe Komisioni i Vlerësimit të Performancës, i cili ka në fokus jo vetëm performancën e stafit akademik të UniBa-s (neni 15), por dhe vlerësimin e procesit akademik, kërkimor, sektorit të çështjeve studentore, vlerësimin e marrëdhënieve me komunitetin, vlerësimin e procesit të administrimit dhe zhvillimit institucional, etj.</p> <p><i>[Evidenca A.1.1, Statuti i Universitetit Barleti]</i>  <i>[Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti]</i>  <i>[Evidenca A.1.19, Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë në UniBa], [Evidenca A.1.19.1, Vendim Nr. 46, datë 24.11.2023 "Për miratimin e përbërjes së Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë në UniBa]</i>  <i>[Evidenca A.1.9, Rregullore e NJZHKC-së], [Evidenca A.3.12, Anëtarët e NJZHKC-së në UniBA, Tabela 24]</i>  <i>[Evidenca A.1.17, Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performacës]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Përveç strukturave që lidhen direkt me menaxhimin e proceseve të sigurimit të brendshëm të cilësisë janë edhe një sërë strukturash që ndërthurin punën e tyre për të përbushur të gjithë strategjinë e UniBa në sigurimin e cilësisë. Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë bashkëpunon ngushtë me Zyrën e Menaxhimit dhe Administrimit të Performancës, Zyrën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Zyrën e Alumnit dhe Karrierës, Zyrën e Pranimeve, Dekanin e studentëve, njësitë bazë e kryesore, studentët alumni e bashkëpunëtorë të tjerë të jashtëm.</p> <p>Në strategjinë UniBa 2020-2030 janë parashikuar objektiva konkretë dhe të matshëm lidhur me përmirësimin e cilësisë së proceseve akademike si p.sh. mësimdhënia dhe të nxënët sipas modelit të kombinuar "online" dhe "ballë për ballë", Punësimi i të diplomuarve, të nxënët gjatë gjithë jetës, përmirësimi i kurrikulave pasurimi i bibliotekës, mirëfunksionimi i strukturave të menaxhimit dhe organizimit në UniBA, ndërkombëtarizimi etj. Përbushja e secilit prej objektivave është parashikuar të arrihet nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë midis strukturave të brendshme dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm të UniBa.</p>



Handwritten signatures in blue ink at the bottom of the page.



	Gjithashtu Komisioni i Vlerësimit të Performancës gjithashtu jep sugjerime dhe rekomandime në funksion të përmirësimit të kulturës së cilësisë në Institucion. Rekomandimet e komisionit përmbledhen në udhëzime të Rektorit për zbatim [Evidenca 'A.1.4, Strategjia e zhvillimit Institucional 2020-2030].			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	<p>UniBa ka një paketë me instrumente për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit që përbëhet nga: formulari vlerësimit të studentëve për lëndën në formën e pyetësorëve anonimë, formulari mbi transparencën e vlerësimit, formulari i vlerësimit kolegë me kolegë, si dhe raporte të vlerësimit të studentëve për pedagogët, lëndën dhe programin.</p> <p>Në kuadër të sigurimit të jashtëm të cilësisë, UniBa i nënshtrohet vlerësimit periodik dhe vlerësimit krahasues institucional dhe të programeve të studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Raporte të vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit gjenden në intranet, dhe publikohen në faqen web të UniBa.</p> <p>[Evidenca A.1.11, Formular vlerësimi i studentëve për lëndën]  [Evidenca A.1.32, Formulari për transparencë të vlerësimit studentëve]  [Evidenca A.1.10, Formular vlerësimi të mësimdhënies kolegë me kolegë]</p>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.	<p>Në mënyrë periodike, çdo anëtar i stafit me kohë të plotë raporton mbi angazhimin e tij gjatë semestrit. Ky raportim përfshin disa aspekte: angazhimin në mësimdhënie, trajnime, projekte, punë kërkimore, punë administrative. Bazuar në këtë vetëdeklarim, por edhe në dokumentat përkatës të departamentit, përgjegjësi i departamentit bën vlerësimin për secilin anëtar të stafit.</p> <p>Krahas vetëdeklarimit, të dhënat që lidhen me angazhimin në mësimdhënie merren edhe nga sekretaria, si orët e realizuara në raport me orët e planifikuara, apo raportime që bën sekretaria në lidhje me mbarëvajtjen e mësimin, provimeve etj. Në varësi të rezultateve, bazuar edhe në Manualin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Institucioni merr vendimet përkatëse, si emërimin në pozicione të caktuara, mbulimin e një pjese të shpenzimeve për konferenca apo aktivitete të tjera kërkimore [A.1.37 Promovim i shembujve të praktikave të mira].</p> <p>Këto bëhen pjesë dhe e diskutimeve në mbledhjet e departamentit, pasqyrohen dhe në dokumentin e raportit të punës vjetore të Institucionit.</p> <p>[Evidenca A.1.15, Format i Raportimit të Punës Semestrale]  [Evidenca A.1.6, Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore]</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			X	
<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			X	



## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL


<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit TOBMSH është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me udhëzimet e MAS, me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Çdo modul/ lëndë ka të përcaktuar kodin, tipin e veprimtarisë, numrin e krediteve etj. Kategorizimi i lëndëve është sipas kategorive A-E, dhe kreditet janë të vendosura në përputhje me përqindjen e parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Totali i krediteve të përfituara në përfundim të studimeve është 120 ECTS.</p> <p><i>[Evidenca A.3.4, Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)]</i></p> <p><i>[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 9]</i></p> <p>Baza ligjore e Rregullores së programit të studimit profesional 2-vjeçar “Teknik në Operacione biznesi, marketing dhe shitje” është si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji Nr. 80/2015 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”</li> <li>• VKM Nr. 418, datë 10.5.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”</li> <li>• VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”;</li> <li>• Statuti dhe Rregullorja e Universitetit “Barleti”.</li> <li>• Udhëzime, akte të tjera ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.</p>	<p>Programi i studimit është i organizuar që studenti të marrë formimin e duhur, për arritjen e rezultateve të të nxënit, njohuri teorike bazë të fushës së studimit dhe aftësim praktik, me qëllim punësimin ose kualifikimin. Programi i studimit është një program i kërkuar jo vetëm nga studentët, por edhe nga agjentë shitjesh, marketerë dhe menaxherë të nivelit të dytë, etj. që kërkojnë të kualifikohen dhe përmirësohen profesionalisht.</p> <p><i>[Evidenca A.3.4, Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)]</i></p> <p>Programi profesional “Teknik në Operacione biznesi, marketing dhe shitje” është konceptuar si një model që kombinon mësimin me praktikën. Programi ofron një përgatitje tërësore, profesionale dhe synon të zhvillojë aftësi për reflektim dhe zhvillim profesional.<sup>2</sup></p>

<sup>2</sup> <https://umb.edu.al/program-studimi/diploma-profesionale/dp-teknik-ne-operacione-biznesi-marketing-dhe-shitje.html>



[Handwritten signatures and initials]

<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>Objektivat formuese të përcaktuara nga departamenti për zhvillimin e programit janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të pajisë studentët me një formim profesional bazë të përqëndruar në njohuritë dhe kompetencat kyçe të domosdoshme për t'i përdorur në karrierën profesionale;</li> <li>2. T'i mundësojë studentëve përvetësimin e njohurive dhe aftësive praktike duke i bërë të aftë për tregun e punës;</li> <li>3. Të nxisë aftësitë aplikative të studentëve dhe shpirtin e sipërmarrjes dhe të iniciativës së lirë.</li> </ol> <p><i>[Evidenca A.2.4, Analizë Vjetore e Punës së Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës 2022-2023].</i></p> <p>Realizimi i këtyre objektivave, strukturimi dhe përmbajtja e planit mësimor të programit TOBMSH ndihmojnë dhe garantojnë përfitimin nga ana e studentëve të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave, që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e tyre në një treg global e dinamik në vazhdimësi.</p> <p><a href="https://umb.edu.al/program-studimi/diploma-profesionale/dp-teknik-ne-operacione-biznesi-marketing-dhe-shitje.html">https://umb.edu.al/program-studimi/diploma-profesionale/dp-teknik-ne-operacione-biznesi-marketing-dhe-shitje.html</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Ndërtimi i planit mësimor të programit TOBMSH është realizuar në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë nr. 80/2015, neni 6 pika 25, neni 70 pika 1 dhe neni 72 pika 1, dhe të VKM "Per elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL".</p> <p>Plani mësimor i programit profesional të studimit në TOBMSH është i organizuar në 2 vite akademikë dhe 4 semestra, me 4 gruplëndësh, 10 lëndë me 20 module ku përfshihen edhe trajnimet praktike (4 trajnime me nga 3 kredite, pra 12 kredite në total) dhe detyrimet përmbyllëse 6 kredite, sic përshkruhet edhe në Tabelën 9: Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese.</p> <p>Çdo modul ka të përcaktuar tipin e veprimtarisë, numrin e krediteve sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), orët mësimore dhe ngarkesat javore.</p> <p><i>[Evidenca A.3.4, Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Programi i studimit profesional 2-vjeçar "Teknik në operacione biznesi, marketing dhe shitje" është organizuar në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p> <p>Gjithashtu pranimi dhe financimi i studentëve me status të veçantë në UniBa bëhet në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin, dhe publikohen në fillim të çdo viti akademik nga Zyra e Rekrutimit, Pranimit dhe Regjistrimit në UniBa. Në këtë kontekst, për vitin akademik 2023-2024 janë dhënë 4 Bursa studimi nga UniBa.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.</p>





70 për qind.				
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	UniBa ka dërguar propozimin për kodifikimin e programeve të studimit dhe jemi në pritje të një përgjigjeje nga ministria përgjegjëse për të finalizuar të gjitha aktet nënligjore. <i>[Evidenca A.1.31, Prot. 431(Dt.27.03.2023) MAS-Dërgohet propozimi për kodifikimin e programeve të studimit]</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

<b>Standardi II.2</b>	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës, është njësi bazë e Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë. Ai e zhvillon veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përmbushje të standardeve të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Universiteti Barleti është akredituar institucionalisht me Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës me numër Nr. 571, datë 12.08.2005 dhe me Vendim i Bordit të Akreditimit Numër Prot. 71, datë 20.01.2022.  <i>[Evidenca A.1.24, Vendim Nr. 571 dt 12.08.2005 - Dhënie leje për hapje të Institucionit]</i> <i>[Evidenca A.1.25, Prot. 71 (Dt. 20.01.2022) ASCAL - Përcillet Vendimi i Bordit të Akreditimit]</i> Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës, përbëhet nga 10 anëtarë të personelit akademik të brendshëm, nga të cilët 1 Prof. Dr; 2 Prof.As. Dr dhe 6 Dr. dhe 1 Msc. Raporti personel akademik efektiv /studentë në nivel njësie kryesore është në përputhje me VKM Nr. 418, datë 10.05.2017.  <i>[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 2]</i> <i>[Evidenca A.1.6.1. Lista e stafit akademik me kohë të plotë, Vendim Rektori me Prot.1044, datë 1.10.2023, për V.A. 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024]</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Fakulteti i Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë <sup>3</sup> ka në përbërje tre njësi bazë: Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës; Departamenti i Qeverisjes, Departamenti i Drejtësisë. Struktura dhe përbërja e tre njësive është në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. <i>[Evidenca A.2.1, Rregullore FEQD]</i> <i>[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 2]</i>

<sup>3</sup> <http://feqd.umb.edu.al>



	<p>Për zhvillimin e praktikave profesionale është ngarkuar stafi i departamentit. UniBa ka nënshkruar një sërë marrëveshesh me institucione të ndryshme dhe organizata të biznesit për zhvillimin e praktikës.</p> <p><i>[Evidenca A.3.9, Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit]</i>  <i>[Evidenca A.3.9.1, Relacion i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit]</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Një prej anëtarëve të stafit akademik të Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës caktohet në detyrën e koordinatorit, dhe është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit profesional 2-vjeçar "Teknik në operacione Biznesi, Marketing dhe shitje" si edhe praktikave profesionale. Koordinatori caktohet nëpërmjet një urdhri të brendshëm të rektorit të UniBa dhe asiston Përgjegjësin e Departamentit për mbarëvajtjen dhe realizimin e punëve në departament. Detyrat e koordinatorit të programit të studimit, i cili është gjithashtu edhe koordinatori i Departamentit, janë përcaktuar në Rregulloren e Departamentit, Neni 6.</p> <p><i>[Evidenca A.2.2, Rregullore e DESF, Neni 6]</i>  <i>[Evidenca A.2.2.1, Vendimi Senatit Akademik Nr. 44, datë 24.11.2023 "Për miratimin e ndryshimit të nenit 6 të rregulloreve të departamenteve të Universitetit "Barleti"]</i>  <i>[Evidenca A.2.3, Urdhri Nr.29, datë 14.10.2022 "Për emërim në detyrë të koordinatorëve të Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X
<p><b>Standardi IL3</b></p> <p><b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.</b></p>				
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>			
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Informacionet për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimit gjenden të publikuara në faqen zyrtare të Universiteti Barleti dhe çdo anëtar i personelit akademik dhe administrativ, ka akses të plotë jo vetëm tek Statuti e rregullorja e institucionit, por edhe tek kurrikula e programeve të studimit, planet mësimore, programet lëndore (syllabuset), rregulloret e programeve të studimit, si edhe aktet e tjera rregullatore të UniBa.</p> <p>Studentët e programit profesional marrin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit dhe lëndët e modulet e tij. Të dhënat e detajuara për programin e studimeve gjenden edhe në faqen zyrtare të universitetit: <a href="https://umb.edu.al/program-studimi/diploma-profesionale/dp-teknik-ne-operacione-biznesi-marketing-dhe-shitje.html">https://umb.edu.al/program-studimi/diploma-profesionale/dp-teknik-ne-operacione-biznesi-marketing-dhe-shitje.html</a></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën</p>	<p>Programi i studimit është i ndërtuar mbi bazën e planit mësimor, i cili jep informacion në lidhje me ndarjen e lëndëve në semestra ngarkesën mësimore në auditor dhe orë punë individuale për çdo lëndë të programit.</p>			



<p>mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p><i>[Evidenca A.3.4, Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Proceset dhe kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve janë të përcaktuara në dokumentat rregullatorë të institucionit UniBa dhe të programit të studimit, në përputhje me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore.</p> <p>Në UniBa studentët informohen dhe orientohen në lidhje me mundësinë e transferimit të programeve të studimeve ose të krediteve të fituara gjatë zhvillimit të tyre. Procesi i transferimit të studimit dhe ekuivalentimit të lëndëve të zhvilluar në një IAL/program të mëparshëm studimi parashikohet në Manualin për Rekrutim, Aplikim, Regjistrim, Transferim të UniBa (Kapitulli VII).</p> <p>Informacioni i detajuar në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të programit të studimit gjenden të publikuara në faqen ëeb të UniBa, të aksesueshme nga kushdo: <a href="https://umb.edu.al/program-studimi/diploma-profesionale/dp-teknik-ne-operacione-biznesi-marketing-dhe-shitje.html">https://umb.edu.al/program-studimi/diploma-profesionale/dp-teknik-ne-operacione-biznesi-marketing-dhe-shitje.html</a></p> <p>Ky informacion mund të merret edhe nëpërmjet Zyrës së Pranimeve dhe Regjistrimeve të UniBa si edhe është i përcaktuar në manualin për rekrutim, aplikim, regjistrim, transferim të UniBa.</p> <p><i>[Evidenca A.1.20, Manual Rekrutim Aplikim Regjistrim Transferim i Studentëve]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve që përmban kurrikula e programit të studimit me karakter profesional "TOBMSH" janë të strukturuar sipas formatit të miratuar, në nivel institucioni, ku paraqitet informacion i detajuar për objektivat e lëndës, temat për secilën javë, format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, si edhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar që studenti duhet të lexojë. Programet lëndore rishikohen dhe miratohen përpara fillimit të vitit akademik nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>[Evidenca A.3.4, Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)]</i> <i>[Evidenca A.3.10, Programet Lëndore të Programit të Studimit]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit, parashikohet plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese, që ofrohen në këtë program dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike. Rishikimi bëhet në konsultim dhe si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës, dinamikave të brendshme. Sikurse u përmend edhe më sipër, syllabuset përditësohen dhe miratohen përpara fillimit të çdo viti akademik, për të garantuar përmirësimin dhe përditësimin e informacionit për studentët.</p> <p>Ndryshimet në planin mësimor bëhen deri në masën 20% për programet e akredituara. Bazë për ndryshimin shërbejnë zhvillimet e vazhdueshme në fushën e biznesit, marketingut dhe shitjeve. Në takimet e shpeshta të departamentit me stafin me kohë të plotë dhe të pjesshëm, me partnerë të jashtëm, me studentë e alumni dalin në pah nevoja për përmirësim, ide të reja dhe propozime për ndryshime që përmirësojnë programet mësimore në përputhje me nevojat e tregut.</p>



	[Evidenca A.3.4, Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)] [Evidenca A.3.10, Programet Lëndore të Programit të Studimit]		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

#### Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit i pajis studentët me njohuri teorike dhe praktike që në përfundim të studimeve të punësohen në përputhje me kualifikimin e fituar ose kur janë në punë të ushtrojnë profesionin e teknikut në një nivel të lartë profesional. Emërtimi i programit është në përputhje me fushën e studimit që mbulon programi. Lëndët janë ndarë në disa profile: Menaxhim, Marketing, Shitje dhe Programim. Lëndët e ofruara janë ndërtuar me qëllim thellimin e mëtejshëm të njohurive të studentëve dhe rritjen e aftësive të tyre profesionale drejt punësimit. Lëndët janë të përcaktuara dhe të shpërndara në mënyrë që të mundësojnë thellimin e njohurive, aftësive të studentëve, si dhe punësimin e tyre pas diplomimit. Lëndët kanë karakter formues menaxherial e operacional, të cilat nxisin tek studentët edhe të menduarin analitik. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave u mundësojnë studentëve të marrin njohuri për të rritur aftësitë e tyre profesionale, me qëllim që të jenë sa më të përgatitur për kërkesat gjithnjë e në rritje të tregut të punës.</p> <p>[Evidenca A.3.5, Studimi periodik i tregut të punës TOBMSH] [Evidenca A.3.4, Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Programi i studimit është i ndërtuar mbi bazën e planit mësimor, i cili jep informacion në lidhje me ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore në auditor dhe orë punë individuale për çdo lëndë të programit. Të gjitha lëndët janë të shpërndara në semestra dhe mundësojnë jo vetëm përmbushjen e rezultatit në procesin e të nxënit, por edhe përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Realizimi i objektivave dhe përmbajtja e planit mësimor të programit të studimit ndihmojnë dhe garantojnë përfitimin nga ana e studentëve të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e tyre në një treg global e dinamik në vazhdimësi.</p> <p>[Evidenca A.3.4, Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit ka të përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të saktë veprimtaritë formuese sipas përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore, referuar VKM Nr. 185, datë 25.3.2021, për disa ndryshime</p>



<p>përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion. Râporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar. Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike, i cili është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p><i>[Evidenca A.3.4, Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)]</i>  <i>[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 9]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arrijten e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teori dhe praktikë i referohen VKM Nr. 185, datë 25.3.2021, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar"</p> <p>Plani mësimor i programit të studimit ka të përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të saktë ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse sipas përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arrijten e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> <p><i>[Evidenca A.3.4, Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)]</i>  <i>[Evidenca A.3.5, Studimi periodik i tregut të punës TOBMSH]</i>  <i>[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabelat 9 dhe 13]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.</p>	<p>Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.</p> <p>Rishikimi bëhet në konsultim dhe si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme. Syllabuset (programet lëndore) përditësohen dhe miratohen përpara fillimit të çdoviti akademik, për të garantuar përmirësimin dhe përditësimin e informacionit për studentët.</p> <p><i>[Evidenca A.3.10, Programet Lëndore të Programit të Studimit]</i>  <i>[Evidenca A.2.7.1, Relacion mbi Platformën e Bibliotekës Online]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>UniBa ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe subjekte të tjera me qëllim aftësimin praktik të studenteve, në përputhje me kërkesat e profesionit dhe tregut dinamik të punës</p> <p><i>[Evidenca A.3.9, Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit]</i>  <i>[Evidenca A.3.9.1, Përfitim nga marrëveshjet e bashkëpunimit]</i>  <i>[Evidenca A.3.14, Infrastruktura akademike në funksion të programit të studimit]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbytja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.</p>	<p>Përmbytja e programit me karakter profesional 2-vjeçar "Teknik në Operacione biznesi, Marketing dhe Shitje", garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.</p>





Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.

Kriteret	Vlerësimi			
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional 2-vjeçar “Teknik në operacione biznesi, marketing dhe shitje” ofron njohuri bazë dhe te avancuara mbi metoda dhe parime shkencore të përgjithshme në fushën e ekonomisë duke mundësuar një njohje të konsoliduar të themeleve të koncepteve rreth menaxhimit, marketingut dhe shitjes.</p> <p>Përgjegjësi i departamentit por edhe stafi akademik janë në kontakt të vazhdueshëm me aktorë nga biznesi apo edhe institucioneve të tjera arsimore për të qenë të informuar mbi zhvillimet më të fundit në tregun e punës në mënyrë që të përshtasin planin mësimor sipas kërkesave të vazhdueshme të tregut.</p> <p><i>[Evidenca A.3.3, Rregullore e studimeve për programin e studimit TOBMSH]</i></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>UniBa dhe Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës në veçanti nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit profesional 2-vjeçar “Teknik në operacione biznesi, marketing dhe shitje”.</p> <p><a href="https://umb.edu.al/zvra-e-karrieres-dhe-alumni.html">https://umb.edu.al/zvra-e-karrieres-dhe-alumni.html</a></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale dhe institucione publike e private.</p>	<p>Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës përmirëson, përditëson, përshtat vazhdimisht programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht



				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

#### Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Universiteti "Barleti" ka në vëmendje zhvillimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Kjo reflektohet edhe nga numri i njësive që ka ngritur për këtë qëllim. Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, e mbështetur nga KSSC-ja në veprimtaritë e saj, synon mbështetjen dhe zhvillimin e një mjedisi akademik që funksionon në përputhje të plotë me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë në të gjithë dimensionet e tij, në atë të mësimdhënies, mësimnxënies, kërkimit shkencor, trajnimeve dhe shërbimeve ndaj komunitetit.</p> <p><i>[Evidenca A.1.19, Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë në UniBa], [Evidenca A.1.19.1, Vendim Nr. 46, datë 24.11.2023 "Për miratimin e përbërjes së Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë në UniBa], [Evidenca A.1.9, Rregullore e NJZHKC-së] dhe [Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 24]</i></p> <p>Referuar planit mësimor të programit të studimit, të ndryshuar deri në masën 20% me vendim senati Nr. 15, dt. 23/03/2023 dhe të miratuar nga MAS me shkresë Nr. 2173/1, dt. 28/04/2023, format e përdorura të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, ushtrimet, labororet, përfshirja në projekte, leksionet e hapura me ekspertë të fushës, praktikat dhe udhëzimet për provimin e përgjithshëm përfundimtar.</p> <p>Ndarja e tyre është si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Leksione – 510 (270+240) orë mësimore</li> <li>2. Seminarë – 300 (165 + 135) orë mësimore</li> <li>3. Labororet – 210 (105 + 105) orë mësimore</li> <li>4. Praktikë – 120 (60 + 60) orë mësimore</li> <li>5. Provë finale – 18 orë mësimore</li> </ol> <p><i>[Evidenca A.1.16, Udhëzim lidhur me punën për hartimin e ngarkesës mësimore për vitin akademik 2022-2023]</i>  <i>[Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH]</i>  <i>[Evidenca A.3.4, Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik,</p>	<p>UniBA synon zhvillimin dhe ruajtjen e një kulture cilësie</p>



Handwritten signatures in blue ink at the bottom of the page.

<p>personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar formë, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>institucioni dhe programi studimi që reflektohet në studentë të përgatitur në përputhje me kërkesat e tregut, nivel i lartë i punësimit të tyre dhe kërkim shkencor që ndikon në zhvillimin e shoqërisë. Personeli akademik është në kontakt të vazhdueshëm me studentët e tij dhe ka zhvilluar forma ndërveprimi me ta duke nxjerrë në pah aftësitë dhe cilësitë e gjithsecilit student, pa kursyer burimet e veta në dispozicion të diversitetit të studentëve dhe, njëkohësisht, duke ruajtur natyrën e veprimtarive formuese që ofron programi i studimit.</p> <p><i>[Evidenca A.1.13, Udhëzues për Metodën e Mësimdhënies], [Evidenca A.1.14, Politika për të mësuarin, mësimdhënien dhe cilësinë në mësimdhënie], dhe [Evidenca A.1.11, Formular Vlerësimi i Studentëve për lëndën], [Evidenca A.1.29, Raport për Vlerësimin e Cilësisë në UniBa]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>UniBa mbështet personelin e tij akademik me ndihmë logjistike (kompjuter, projektor dhe pajisje të tjera plotësuese), me trajnime informuese mbi metodat e reja dhe inovative në fushën e mësimdhënies (përfshirë këtu përdorimin e teknologjisë së informacionit) dhe me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për të ofruar qasje inovative në procesin e mësimdhënies, duke iu përshtatur kështu sa më mirë nevojave dhe kërkesave të studentëve <i>[Evidenca A.1.34, Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit në UniBa]</i> dhe <i>[Evidenca A.1.39. Verifikimi i kapaciteteve pritëse të UniBa].</i></p> <p>Gjithashtu në mbështetje të personelit akademik zhvillohen dhe konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare për të nxitur kërkimin shkencor cilësor, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm profesional dhe të karrierës akademike. Këto lehtësira janë zhvilluar për të mundësuar përdorimin e formave të reja didaktike në shërbim të mësimdhënies e mësimnxënies, si dhe të arritjes së objektivave formues.</p> <p><i>[Evidenca A.1.36, Lista e Konferencave, Trajnimeve dhe Workshop-eve], [Evidenca A.2.4, Analiza Vjetore e Departamentit për vitin akademik, 2022-2023], [Evidenca A.2.5, Raport Vjetor për Kërkimin Shkencor në Departament, 2022-2023] dhe [Evidenca A.2.6, Plan Pune për Zhvillimin e DESF, 2023-2024]</i></p> <p>Në kuadër të realizimit optimal të programit të studimit dhe të aftësimit e zhvillimit profesional të stafit akademik, UniBa ka nënshkruar edhe një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me universitete të ndryshme të Evropës dhe jo vetëm, duke ofruar kështu mundësi mobiliteti për personelin akademik. <i>[Evidenca A.1.12, Strategjia e Ndërkombëtarizimit, UniBa]</i> dhe <i>[Evidenca A.1.35, Të dhëna mbi MoU, UniBa].</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik të student. Në të njëjtën kohë, siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar është plotësisht përgjegjës në fushën e vet shkencore, duke qenë se është personeli i formuar në universitetet më në zë vendase dhe të huaja dhe arrin të përcjellë dijet me përgjegjësi shkencore te brezi i ri nëpërmjet metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies <i>[Evidenca A.1.6, Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore UniBa], [Evidenca A.1.6.1, Lista e Stafit Akademik me Kohë të Plotë, Vendim Rektorati me Prot.1044, datë 1.10.2023, për V.A. 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024]</i> dhe <i>[Evidenca A.3.11, CV e stafit akademik të programit të studimit].</i></p> <p>Personeli akademik përdor punë krijuese në grup, projekt-ide dhe studime rastesh për të arritur objektivat e caktuara të një moduli. Gjatë leksioneve, seminareve dhe laboratoreve studentët përfshihen me pyetje, komente apo</p>



<p>marrëdhëniet të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>opinione për çështje të ndryshme. Ndërkaq, prezantimi i projekteve/ detyrave të kursit organizohet në formë prezantimi, gjë e cila hap diskutim për përfshirjen edhe të studentëve të tjerë duke iu dhënë mundësinë atyre të nxisin procesin e mendimit kritik. Mësimdhëniet me fokus studentin krijojnë mundësinë e zhvillimit të aftësive krijuese, të mendimit kritik dhe atij të pavarur, duke mundësuar në këtë formë ndërtimin e një mjedisi bashkëpunues dhe frytdhënës për palët.</p> <p><i>[Evidenca A.3.10, Programet Lëndore të Programit të Studimit], [Evidenca A.2.4, Analiza Vjetore e Departamentit për vitin akademik, 2022-2023] dhe [Evidenca A.2.5, Raport Vjetor për Kërkimin Shkencor në Departament, 2022-2023], [Evidenca A.1.29, Raport për Vlerësimin e Cilësisë në UniBa], [Evidenca A.1.30, Raporti Vjetor UniBa 2022-2023]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Personeli akademik është në pritje profesionale të vazhdueshme në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, duke mbështetur studentët në sugjerimet e tyre të dala nga bashkëbisedimet e përditshme, pyetësorët, etj. Në funksion të përmirësimit të punës mësimore, NJZHKC organizon vlerësimin e procesit mësimor dhe punës së stafit akademik nëpërmjet anketimit të studentëve Barletas për lëndët e këtij programi studimit, në fund të çdo semestri. Studentët i përgjigjen pyetësorit të dërguar nga NJZHKC, e cila më pas bën edhe përpunimin e të dhënave. Rezultatet e pyetësorit i përcillen stafit akademik, në mënyrë që të reflektojnë në punën e tyre të kërkesat dhe sugjerimet e studentëve.</p> <p><i>[Evidenca A.1.11, Formular Vlerësimi i Studentëve për lëndën], [Evidenca A.1.29, Raport për Vlerësimin e Cilësisë në UniBa], [Evidenca A.1.30, Raporti Vjetor UniBa 2022-2023]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>UniBa nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies referuar rezultateve të nxjerra nga proceset monitorim-vlerësim dhe vetëvlerësimi i vetë pedagogut të modulit. Procesi i vlerësimit të performancës zhvillohet në 2 seksione në vit që përkojnë me mbarimin e semestrave akademikë.</p> <p><i>[Evidenca A.1.9, Rregullore e NJZHKC-së], [Evidenca A.1.10, Formular vlerësimi të mësimdhënies kolegë me kolegë] dhe [Evidenca A.1.17, Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës]</i></p> <p>Institucioni promovon në mënyrë të vazhdueshme stafin dhe e nxit atë për realizimin cilësor të mësimdhënies, gjë e cila realizohet edhe me organizimin dhe zhvillimin në mënyrë periodike të trajnimeve, kryesisht për metodat e reja dhe inovative në fushën e mësimdhënies me lektorë të ftuar, vendas e të huaj, dhe pjesëmarrjen e personelit akademik në projekte kombëtare e ndërkombëtare me të cilat UniBa është partnere.</p> <p><i>[Evidenca A.1.30, Raporti Vjetor UniBa 2022-2023], [Evidenca A.1.36, Lista e Konferencave, Trajnimeve dhe Workshop-eve], [Evidenca A.1.37, Promovim i shembujve të Praktikave të mira], [Evidenca A.2.5, Raport Vjetor për Kërkimin Shkencor në Departament, 2022-2023].</i></p> <p><i>[Evidenca A.1.29, Raport për Vlerësimin e Cilësisë në UniBa], [Evidenca A.1.30, Raporti Vjetor UniBa 2022-2023].</i></p> <p><i>[Evidenca A.1.12, Strategjia e Ndërkombëtarizimit, UniBa 2019-2023], [Evidenca</i></p>



<i>A.1.35, Të dhëna mbi MoU, UniBaj.</i>														
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>										
				X										
<b>Standardi III.2</b>														
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>														
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>													
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/ Rregulloren e Institucionit/ rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Institucioni ka hartuar rregulloren e programit të studimit bazuar në rregulloren e UniBA, e cila mbulon të gjithë procesin akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Në kreun III, Neni 17, pika 1 përcaktohen kriteret dhe mënyrat e vlerësimit të dijeve dhe njohurive të studentit, te cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët. Çdo fillim viti akademik studentët informohen nëpërmjet përgjegjësit dhe koordinatorit të departamentit mbi rregulloren e programi të studimit/ rregulloren e Institucionit/ rregullore të posaçme dhe jepen shpjegimet e duhura për çdo rast në varësi të kërkesave gjatë vitit akademik.</p> <p><i>[Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti]</i>  <i>[Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH]</i>  <i>[Evidenca A.2.3, Vendim i emërimit në detyrë të koordinatorit të DESF]</i></p>													
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Pedagogët e angazhuar në programin e studimit i njohin studentët në fillim të procesit mësimor me programin lëndor, ku theksohet metodologjia e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në programin e lëndës/ modulit. Gjithashtu, pedagogu i lëndës jep afalet për secilin detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës/ modulit (Kreu III, neni 17, Rregullore e programit TOBMSH).</p> <p>Kontrolli dhe vlerësimi i vazhdueshëm i njohurive dhe dijeve të tyre bazohet në komponentët e mëposhtëm të vlerësimit, të përcaktuara nga titullari i lëndës/ modulit në konsultim me përgjegjës të departamentit për arsye se pesha specifike është subjekt ndryshimi sipas specifikave të fushës, me përjashtim të provimit të ndërmjetëm. Peshat specifike e këtij të fundit nuk duhet të jetë më e vogël se 20%. Zhvillimi i provimit përfundimtar është i detyrueshëm, pavarësisht sasisë së pikëve të grumbulluara nga komponentët e tjerë të vlerësimit.</p> <table border="1" style="width: 100%; margin-top: 10px;"> <thead> <tr> <th style="text-align: left;">Komponentët e vlerësimit</th> <th style="text-align: center;">Pesha (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Provimi i ndërmjetëm</td> <td style="text-align: center;">20</td> </tr> <tr> <td>Pjesëmarrja dhe aktivizimi</td> <td style="text-align: center;">-</td> </tr> <tr> <td>Detyra e kursit<sup>4</sup></td> <td style="text-align: center;">-</td> </tr> <tr> <td>Provimi përfundimtar<sup>5</sup></td> <td style="text-align: center;">50</td> </tr> </tbody> </table>				Komponentët e vlerësimit	Pesha (%)	Provimi i ndërmjetëm	20	Pjesëmarrja dhe aktivizimi	-	Detyra e kursit <sup>4</sup>	-	Provimi përfundimtar <sup>5</sup>	50
Komponentët e vlerësimit	Pesha (%)													
Provimi i ndërmjetëm	20													
Pjesëmarrja dhe aktivizimi	-													
Detyra e kursit <sup>4</sup>	-													
Provimi përfundimtar <sup>5</sup>	50													

<sup>4</sup> Detyra e kursit mund të jetë: ese, punë në grup, rast studimor, projekt, prezantim, performancë sportive ose artistike, etj. Ajo përcaktohet nga titullari, në varësi të specifikave të lëndës.

Periudha e zhvillimit të provimit të ndërmjetëm, dhe periudha e zhvillimit dhe/ose dorëzimit të detyrës së kursit, vendosen në javën/të përkatëse në syllabus: Provimi i ndërmjetëm, në varësi të specifikave të lëndës/modulit, zhvillohet në javën e gjashtë ose të shtatë, dhe kontrollon njohuritë e temave të zhvilluara në pesë javët e para. Provimi i ndërmjetëm zhvillohet në orën e seminarit/praktikës së javës përkatëse.




*[Handwritten signatures in blue ink]*

	<b>TOTALI</b>	<b>100</b>		
	<p>Pas përfundimit të orës së parë të mësimit programi lëndor i shpërndahet studentëve ndërmjet e-mailit zyrtar.</p> <p><i>[Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH] dhe [Evidenca A.3.10, Programet Lëndore të Programit të Studimit]</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive të studentit është gjithësemestral, i cili realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p> <p>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nëpërmjet vlerësimit formues ose të vazhduar dhe atij përmbledhës. Format e vlerësimit të vazhduar konsistojnë në përfundimet e kontrollit të vazhdueshëm dhe në frekuentimin/ pjesëmarrjen aktive në leksione, seminare, praktika, punë krijuese, punime të ndryshme, detyra kursi dhe provimit të ndërmjetëm. Vlerësimi përfundimtar i njohurive është bashkimi i vlerësimit të vazhdueshëm me vlerësimin përmbledhës që realizohet me anë të provimit në fund të realizimit të programit mësimor të lëndës/ modulit.</p> <p><i>[Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti]</i>  <i>[Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH] dhe [Evidenca A.3.10, Programet Lëndore të Programit të Studimit]</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>
<b>Standardi III.3</b>				
<p>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</p>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>			
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e përfundimtar ve/moduleve nga</p>	<p>Mbështetur në syllabuset e lëndëve, vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve realizohet gjatë gjithë kohës së zhvillimit të lëndës/ modulit në mënyrë të vazhdueshme dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/ modulit. Kështu, vlerësimi përfundimtar realizohet përmes komponentëve të ndryshëm që vendosen sipas kriterëve të percaktuara në syllabuse dhe aktet e brendshme rregullatore <i>[Evidenca A.3.10, Programet Lëndore të Programit të Studimit]</i>.</p> <p>Pesha specifike e provimit të ndërmjetëm është 20%, ndërsa komponentët e tjerë të vlerësimit lihen në gjykimin dhe kompetencën e pedagogut të lëndës, i cili konsultohet me përgjegjësin e departamentit për arsye se pesha specifike është subjekt ndryshimi sipas specifikave të fushës. Zhvillimi i provimit përfundimtar është i detyrueshëm, pavarësisht sasisë së pikëve të grumbulluara nga komponentët e tjerë të vlerësimit <i>[Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH]</i>.</p>			

<sup>5</sup> Zhvillimi i provimit përfundimtar është i detyrueshëm, pavarësisht sasisë së pikëve të grumbulluara nga komponentët e tjerë të vlerësimit.


Faqe 30




titullari i lëndës/modulit.																									
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	N/A																								
<b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	<p>Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me programin lëndor [Evidenca A.3.10, Programet Lëndore të Programit të Studimit] dhe bazën ligjore në fuqi referuar Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, me specififikimet e bëra në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, si dhe Vendimin Nr. 879 datë 18.12.2019 “Disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41 datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave”, ndryshuar.</p> <p>Institucioni ka formate standarde të testimit që vihen në dispozicion të stafit akademik nga koordinatori i departamentit [Evidenca A.3.13, Vendim Rektorati, Nr. 94 dt. 12.02.2021 “Për miratimin e formatit të provimeve, etj”]. Shkalla e përvetësimit të dijes nga studentët bëhet sipas sistemit me notë, me pikë ose me përqindje dhe vlerësimi duhet të shprehet detyrimisht me notë, sipas Kreu III, neni 17 në rregulloren e programit të studimit, si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="414 1052 1388 1232"> <thead> <tr> <th colspan="8">Tabela e Vlerësimit</th> </tr> <tr> <th>Përqindja p (%)</th> <th><math>0 \leq p &lt; 50</math></th> <th><math>50 \leq p &lt; 56</math></th> <th><math>56 \leq p &lt; 66</math></th> <th><math>66 \leq p &lt; 76</math></th> <th><math>76 \leq p &lt; 86</math></th> <th><math>86 \leq p &lt; 96</math></th> <th><math>96 \leq p \leq 100</math></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Nota</td> <td>4</td> <td>5</td> <td>6</td> <td>7</td> <td>8</td> <td>9</td> <td>10</td> </tr> </tbody> </table>	Tabela e Vlerësimit								Përqindja p (%)	$0 \leq p < 50$	$50 \leq p < 56$	$56 \leq p < 66$	$66 \leq p < 76$	$76 \leq p < 86$	$86 \leq p < 96$	$96 \leq p \leq 100$	Nota	4	5	6	7	8	9	10
Tabela e Vlerësimit																									
Përqindja p (%)	$0 \leq p < 50$	$50 \leq p < 56$	$56 \leq p < 66$	$66 \leq p < 76$	$76 \leq p < 86$	$86 \leq p < 96$	$96 \leq p \leq 100$																		
Nota	4	5	6	7	8	9	10																		
<b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	<p>Provimet vlerësohen nga pedagogu/ pedagogët që kanë zhvilluar lëndën. Hartimi i testit përmblendës miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit. Fleta e vlerësimit firmoset nga Dekani i Fakultetit dhe kryesekretarja.</p> <p>Vlerësimi formues ose i vazhduar i studentit gjatë vitit akademik bazuar në leksione, seminare, teste formuese, detyra kursi shoqërohet me komente për studentin me qëllim që ai të kuptojë gjendjen dhe të nxitet për t’u përmirësuar.</p> <p>Për zhvillimin e testit përmblendës zhvillohet paraprakisht seancë shpjeguese me studentët, bëhet përmblendje e temave dhe koncepteve kryesore të trajtuara, zhvillohet me ta model testi final dhe rishpjegohen kriteret e vlerësimit. Të gjitha këto synojnë që studentin të përmirësohet në performancën që do të paraqesë dhe të jetë i vetëdijshëm për vlerësimin.</p> <p>[Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti] dhe [Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH]</p>																								
<b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk	UniBa ka hartuar Kodin e Etikës, ku krahas të tjerave parashikohet edhe shmangia e plagjiaturës. Neni 4 (Parimet), pika 6 theksohet se ndalohet plagjiatura e çdo lloji [Evidenca A.1.5, Kodi i Etikës i UniBa] dhe [Evidenca A.1.5.1, Vendim Nr. 34, datë 24.11.2022 “Për miratimin e përbërjes së Këshillit të Etikës”].																								



<p>lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Salla e provimit monitorohet nga pedagogët e departamentit dhe sekretaria mësimore, sipas rastit. Në sallën e provimit nuk lejohet që të hyjnë persona të tjerë, përveç pedagogut të modulit, punonjësit të sekretarisë që bën sekretimin e tezave dhe të monitoruesve të ngarkuar sipas rastit nga Departamenti. Nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë për asnjë rast. Konsiderohen shkelje të rregullave të UniBa të gjitha veprimet e kryera me dashje nga studenti, përfshirë ato që përbëjnë cënim të normave shoqërore dhe etiko-morale, si: kopjimi, plagjiatura a paraqitja si punë e vet e punës së një tjetri; dhënia ose marrja e informacionit me gojë a me shenja gjatë provimit.</p> <p>Në Rregulloren e Universitetit, në Nenin 111 (veprimet në shkelje të rregullave të UniBa) dhe Neni 112 (masat disiplinore), specifikohet se ndaj studentit që kryen kopjim gjatë një provimi, plagjiaturë etj. mund të merren masa disiplinore, duke filluar nga vërejtje me shkrim e deri në përjashtim përgjithmonë nga universiteti [Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti] dhe [Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH].</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësiwe profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Vlerësimet e studentëve dokumentohen në procesverbalin e vlerësimit semestral/ vjetor dhe në Regjistrin e Rezultateve Akademike. Procesverbali i vlerësimit semestral/ vjetor plotësohet nga pedagogu/ pedagogët në përfundim të procesit të vlerësimit dhe dorëzohet në sekretari jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e provimit. Fleta e vlerësimit firmoset nga Dekani i Fakultetit dhe kryesekretarja. Vlerësimet komunikohen nga sekretaria e UniBa-s.</p> <p>[Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH, Neni 20 dhe 21]</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Në takimin pas realizimit të provimit, pedagogu i modulit deklaron rezultatin e provimit të studentit dhe pas dakordësisë, i regjistron të njëjtat në fletën e vlerësimit me qëllim që t'u jepet mundësia studentëve të njihen paraprakisht me notat e vendosura.</p> <p>Në rast se studenti mendon se ka pasur gabim në llogaritjen e pikëve dhe të notës, ose gjatë shënimit të notës, ka të drejtë të kontaktojë pedagogun e modulit dhe të diskutojnë për vlerësimin. Nëse kërkesa e tij gjendet e justifikuar, bëhet ndryshimi i duhur sipas procedurës, para se nota të regjistrohet në sistem [Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti] dhe [Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH].</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente</p>	<p>Sipas nenit 90 të Rregullores së Universitetit, studenti ka të drejtën e ankimit për vlerësimin e marrë dhe të marrë përgjigje sipas rregullave të përcaktuara. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 48 orëve nga marrja e komunikimit të notës pas përfundimit të lëndës/ modulit, por para shënimit të notës në Regjistrin e Arritjeve Akademike.</p> <p>Përgjegjësi i departamentit bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë në dijeni dekanin, i cili brenda 48 orësh ngrë një komision <i>ad hoc</i> për shqyrtimin e ankesës. Me miratimin e dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit ose përsëritjen e tij me komisionin e miratuar nga dekanin [Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti].</p>







për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X
<b>Standardi III.4</b>			
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.			
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>		
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit profesional “Teknik ne Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje” synon pajisjen e studentëve me një formim akademik bazë të përqëndruar në njohuritë dhe kompetencat kyçe të domosdoshme për karrierë profesionale në marketing dhe shitje, si dhe aftësimin për të përballuar ndryshimet e vazhdueshme të tregut të punës në këtë sektor. Filozofia arsimore dalluese e këtij programi është se promovon kombinimin e studimit akademik me mësimin e aplikuar në botën profesionale. Kompetencat specifike të programit lidhen me aftësimin për njohjen dhe aplikimin e teknikave të operacioneve të biznesit, marketingut dhe shitjes në tërësi, si dhe elemente të tyre si njohja e procesit të përgatitjes së produkteve për shitje apo psikologjia e konsumatorit ndaj të cilit do të orientohen këto operacione etj. <i>[Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH].</i>		
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	<p>Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, shkencave humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit. Më konkretisht, ky program i studimit ofron modulet “Bazat e Programimit në Marketing” dhe “Njohuri Programimi për shitjet On-line”, të cilat zhvillohen përkatësisht në vitin e dytë dhe kanë në fokus tema dhe çështje që lidhen me përdorimin kompjuterik/programues. Gjithashtu, lëndë të tjera si “Marketingu Dixhital” dhe “Sisteme Dixhitale të Shitjes” kanë në fokus përdorimin e teknologjisë digjitale për marketingun. Modulet e sipër cituara përmbajnë një sërë temash që realizojnë formimin teorik dhe synojnë gjithashtu aftësimin praktik për përdorimin e teknologjisë për marketing dhe shitje.</p> <p>Në lëndët e tjera të programit përfshirja e teknologjisë së informacionit është bërë në shumë forma. Përdorimi i TIK u jep mundësi pedagogëve dhe studentëve për akses në më shumë burime informacioni dhe për zbatim të aplikimeve që lidhen me tema të ndryshme. Aftësitë e tjera në fushat humane dhe sociale të komunikimit e ndërveprimit trajtohen në modulet “Puna në Grup dhe Komunikimi”, “Etika në Grup dhe Komunikimi” dhe “Psikologjia e Konsumatorit” për të aftësuar studentët në elemente që do të ndihmojnë ndërveprimin e tyre me klientët apo operatorët e tjerë ekonomikë gjatë ushtrimit të profesionit, pasi janë diplomuar në këtë program studimi.</p> <p><i>[Evidenca A.3.4, Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)]</i>  <i>[Evidenca A.3.10, Programet Lëndore të Programit të Studimit]</i></p>		



*[Handwritten signatures in blue ink]*

<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p> <p>Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Në analizën e departamentit shqyrtohet gjerësisht niveli i kompetencave dhe aftësive profesionale të fituara nga studentët në përfundim të lëndëve, sfidat në arritjen e tyre, efektiviteti i metodave të zbatuara në mësimdhënie, përfshirja dhe aktivizimi i studentëve në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Të gjitha këto kanë synim t'i përmirësojnë në të ardhmen treguesit e sipër cituar.</p> <p>Në përfundimit të lëndës pedagogët bëjnë një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara, duke përfshirë në diskutim studentët dhe mendimin e tyre mbi përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë. Gjithashtu, pedagogët e lëndës qartësojnë përmbajtjen mbi të cilën do të ndërtohet testi përmbledhës dhe në shumë raste zhvillojnë edhe një model testi që mund t'u shërbejë studentëve të njihen me treguesit kryesorë që kanë lidhje me llojin dhe numrin e pyetjeve, nivelet e vështirësisë së pyetjeve dhe pjesët e programit që përfaqësojnë, kohën e testit dhe mënyrën e vlerësimit të përgjigjeve. Ndërkohë që detyrimet përmbyllëse u janë bërë me dije studentëve që në fillim të modulit/ lëndës me anë të programit lëndor përkatës. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të cilat pasqyrohen në objektivat e vendosura në programin e lëndës, evidentohen në radhë të parë në rezultatet e tyre në format e ndryshme të testimit përgjatë vitit akademik dhe në provimet përfundimtare.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Programi formon dhe zhvillon kompetenca të përgjithshme, specifike dhe të transferueshme të cilat mundësojnë menaxhim dhe transformim të konteksteve të punës, qëndrim të pavarur, performancë të efektshme. Praktika profesionale parashikon të mundësojë përdorimin e kompetencave të fituara në kurset teorike në një kontekst praktik profesional. Për të plotësuar kërkesat e parashikuara, studentët duhet të zhvillojnë praktikë çdo semester në një ose disa institucione ose në institucionin ku studentët janë të punësuar.</p> <p>Gjatë zhvillimit të procesit mësimor në të gjitha lëndët pedagogët krijojnë një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative e shkencore të studentëve. Staffi inkurajon studentët të zhvillojnë ide dhe t'i bëjnë ato të zbatueshme në fushat përkatëse dhe në profesionin e tyre.</p> <p><i>[Evidenca A.1.7, Paketa e Praktikës për programet profesionale, 2022-23]</i>  <i>[Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH]</i>  <i>[Evidenca A.3.9. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit]</i>  <i>[Evidenca A.3.9.1, Relacion i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në mënyrë të vazhdueshme në rang universiteti dhe departamenti realizohen leksione të hapura dhe seminare për zhvillime reja të rëndësishme të shkencës dhe teknologjisë, me pjesëmarrjen e profesionistëve të fushave të ndryshme brenda dhe jashtë programit <i>[Evidenca A.2.4, Analizë vjetore e punës së DESF, 2022-2023]</i>.</p> <p>Në këtë drejtim zhvillohen 'open innovation' në lidhjet e tij të ngushta me bizneset dhe industrinë. UniBa ka zbatuar politikën e përfshirjes së lektorëve dhe kërkuesve shkencorë në faza të ndryshme të procesit mësimor, si element të rëndësishëm për shkëmbimin e ideve dhe metodave të mësimdhënies. Të ftuarit kanë qenë nga fusha të ndryshme dhe që kanë spikatur në fushat e tyre.</p> <p>Në fillim të vitit akademik çdo departament miraton kalendarin e aktiviteteve që do të zhvillojë përgjatë vitit, duke u dhënë mundësinë studentëve të programeve që ai mbulon të njihen me profesionistë të fushave të ndryshme.</p>



	[Evidenca A.1.33.4, Strategji e Klubeve Studentore] dhe [Evidenca A.1.33.9, Plani i punës Dekani i Studentëve 2023-2024]		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X
<b>Standardi III.5</b>			
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.			
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>		
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	<p>Për të fituar “Diplomën Profesionale” në “Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje”, studenti duhet të ketë siguruar 120 kredite. Rregullore e programit të studimit dhe rregullorja UniBa përmban në mënyrë të detajuar të gjitha kriteret dhe procedurat e diplomimit. Si rezultat i ndryshimeve profilizuese (deri në masën 20%) në planin mësimor të këtij programi studimi, të miratuara nga Senati Akademik i UniBa bazuar në nenin 35, pika 9, të Ligjit Nr. 80//2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, detyrime përmbyllëse (kategoria E, tabela 9) ndryshohet nga “Trajnim Praktik - 12 ECTS” në “Provim Përfundimtar - 6 ECTS”, duke filluar nga viti akademik 2023-2024 [Evidenca A.3.4, Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)].</p> <p>Prandaj, studimet përmbyllen me provën finale që është në trajtën e provimit të përgjithshëm përfundimtar. Kërkesat dhe procedurat për provën finale përcaktohen në aktet e brendshme rregullatore.</p> <p>Procedura për provimin final saktëson që:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Studenti duhet të marrë 120 kredite.</li> <li>2. Mbrojtja e provës finale bëhet në dy sesione, të cilët përcaktohen në kalendarin akademik.</li> <li>3. Kandidati diplomant, i cili rrëzohet në sesionin e parë të mbrojtjes së diplomës ka të drejtë të riparaqitet për mbrojtje në sesionin e ardhshëm.</li> <li>4. Kandidati që nuk e fiton mbrojtjen e provës finale për herë të dytë pajiset me një dëshmi ku bëhet shënimi “i padiplomuar” dhe ku paraqiten rezultatet e arritura.</li> </ol> <p>[Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti] dhe [Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH]</p>		
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	<p>DESF harton programin e provimit të formimit në zbatim të Vendimit të Senatit, nr. 14, dt.07.12.2015.</p> <p>Personeli akademik i programit të studimit asiston dhe ndihmon studentët duke i dhënë atyre herë pas here informacion, udhëzime për materialet që duhet të përdorin dhe studiojnë në funksion të provës finale. Qëllimet e këtij programi orientues janë: (i) lehtësimi i punës individuale të studentit për të rifreskuar njohuritë teorike të marra përgjatë programit të studimit; dhe (ii) lehtësimi i inventarizimit të literaturës përkatëse, e cila do të përdoret për përgatitjen e provimit të përgjithshëm përfundimtar.</p>		
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë	<p>Për të fituar “Diplomë Profesionale” në “Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje”, studenti duhet të ketë plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor për këtë program studimi. Duke filluar nga viti akademik 2023-2024, studimet do të përmbyllen me provën finale në trajtën e provimit të përgjithshëm përfundimtar. Në kuadër të detyrimeve përmbyllëse për studentin,</p>		



të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	ata njihen me programin e provimit të formimit dhe orientohen në lidhje me fushat specifike që do të përfshihen në provimin përfundimtar. Ky program shërben si udhërrëfyes për të ndihmuar studentët e programit të studimit me qëllim rifrëskimin e njohurive të marra përgjatë 2 viteve akademike dhe për të lehtësuar përgatitjen e tyre për provën finale. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar, i ngritur për vlerësimin e studentëve, bazohet në testimin e njohurive të ofruara gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. Ky komision ngrihet me vendim departamenti; ditën e provimit komisionit i vihet në dispozicion teza e provimit me numrat përkatës, të cilat përzgjidhen nga studentët dhe paraqiten një nga një përpara komisionit për realizimin e provimit përfundimtar (sipas tezës së përzgjedhur).
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	[Evidenca A.3.4, Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)] [Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH] N/A
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.	Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij me anë të një pedagogu udhëheqës, i caktuar në bazë të temës/ temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit. Studenti duhet të marrë mbështetjen e duhur nga pedagogu mentor i praktikës.
<b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë.	[Evidenca A.1.7, Paketa e Praktikës për programet me karakter profesional] [Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH] Mbështetur në procedurën e diplomimit bazuar në rregulloren e programit të studimit, studenti në provimin final vlerësohet me notë dhe me kreditet e fituara.
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me "Çertifikatë profesionale" ose "Diplomë profesionale" në fushën e arsimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	[Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH] Në përfundim të studimeve profesionale, studenti pajiset me diplomë dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Gjithashtu, me kërkesë të studentit, mund t'i vihet në dispozicion edhe një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit në "Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje". [Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH] [Evidenca A.3.7, Formati i diplomës TOBMSH] [Evidenca A.3.7.1, Urdhëri i MAS] dhe [Evidenca A.3.7.2, Vërtetim nga QSHA për dokumentin që shoqëron diplomën].



Handwritten signatures in blue ink, including a large signature in the center and several smaller ones to the left and right.

<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Në arkivin e sekretarisë të UniBa mbahet për një periudhë të pacaktuar një kopje e dokumentacionit të secilit student. Ky dokumentacion aksesohet sa herë lind nevoja ose kërkohet informacion në lidhje me studentët.</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p>X</p>

**Standardi III.6**

**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve <i>[A.1.34, Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së TIK]</i></p> <p>Gjatë zhvillimit të procesit mësimor në të gjitha lëndët pedagogët krijojnë një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative të studentëve. Stafit inkurajon studentët të zhvillojnë ide dhe t'i bëjnë të zbatueshme ato në fushat përkatëse dhe profesionin e tyre në mësimdhënie e të nxënë <i>[Evidenca A.3.3, Rregullore e Programit me karakter Profesional TOBMSH], [Evidenca A.1.13, Udhëzues për Metodën e Mësimdhënies]</i> dhe <i>[Evidenca A.1.14, Politika për të mësuarin, mësimdhënien dhe cilësinë në mësimdhënie]</i>.</p> <p>Të gjitha mjediset mësimore janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, të cilat garantojnë realizimin e procesit mësimor. Një ndër objektivat kryesorë strategjikë të UniBa është dixhitalizimi. Në kampusin e ri të UniBa të gjithë auditorët janë të pajisur me smartboard dhe sisteme projektimi digjital, përfshirë të gjitha mjetet e tjera të nevojshme audio dhe video. Në funksion të digjitalizimit i gjithë kampusi është i mbështetur edhe me rrjet Wifi dhe pajisjet e nevojshme elektronike si PC, laptop, printera, skaner, etj në zyrat e stafit akademik dhe atij administrative.</p> <p><i>[Evidenca A.1.39. Verifikimi i kapaciteteve pritëse të UniBa]</i> dhe <i>[Evidenca A.3.14, Infrastruktura akademike në funksion të programit të studimit]</i>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Njësia e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë, Zëvendës Rektori për Çështjet Akademike, Zyra e Menaxhimit të Vlerësimit të Performancës dhe njësitë bazë e kryesore janë strukturat që bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë punën e tyre për monitorimin, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e mësimdhënies së personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p> <p>Njësia e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë dhe Zyra e Menaxhimit të Vlerësimit të Performancës, në mënyrë të vazhdueshme, monitorojnë procesin e mësimdhënies nëpërmjet të dhënave të mbledhura nga stafi akademik, nga njësitë bazë e kryesore, nga studentët dhe nga stafi administrativ, si edhe mbi bazën e tyre gjykohet për nevojën për përmirësim të proceseve mësimore dhe atyre administrative.</p> <p>Pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë janë edhe</p>


The bottom of the page features several handwritten signatures in blue ink. To the right, there is a prominent red circular stamp of the University of Tirane, containing the university's name in Albanian and English, along with a central emblem.


	<p>studentët. Mendimet e tyre janë mjaft të rëndësishme dhe vijnë nëpërmjet pyetësorëve si edhe fokus grupeve.</p> <p>Pyetësorët realizohen 2 herë në vit/ në përfundim të çdo semestri dhe studentët kanë mundësi të vlerësojnë jo vetëm lëndën, por edhe metodat e mësimdhënies që përdor pedagogu, mënyrën e transmetimit të dijeve, literaturën, etj. Në përfundim hartohet raporti i vlerësimit të studentëve i cili me rekomandimin e rektorit të institucionit i dërgohet departamenteve.</p> <p><i>[Evidenca A.1.9, Rregullore e NJZHKC-së]</i>  <i>[Evidenca A.1.10, Formular vlerësimi të mësimdhënies kolegë me kolegë]</i>  <i>[Evidenca A.1.11, Formular Vlerësimi i Studentëve për lëndën]</i>  <i>[Evidenca A.1.15, Format i Raportimit të Punës Semestrale]</i>  <i>[Evidenca A.1.16, Udhëzimi i lidhur me punën për hartimin e ngarkesës mësimore për vitin akademik 2022-2023]</i>  <i>[Evidenca A.1.17, Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performacës]</i>  <i>[Evidenca A.1.19, Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë në UniBa], [Evidenca A.1.19.1, Vendim Nr. 46, datë 24.11.2023 "Për miratimin e përbërjes së Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë në UniBa]</i></p>								
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Struktura Organizative UniBa është në përputhje me ligjin e arsimit të lartë Nr. 80/2015 si për nga organizimi, ashtu edhe nga ndarja e detyrave të cilat janë të përshkruara në mënyrë të detajuar në statutin e institucionit, rregulloren e Uniba dhe në aktet e tjera rregullatorë. Strukturat kryesore përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë janë Komisioni i Sigurimit të Standardeve dhe Cilësisë dhe Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë. Këto struktura bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p> <p><i>[Evidenca A.1.2, Organigrama e UniBa]</i></p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies, nëpërmjet financimit të pjesëmarrjes së tyre në aktivitete të ndryshme kërkimore-shkencore dhe projekte.</p> <p><i>[Evidenca A.1.37, Promovim i shembujve të praktikave të mira]</i>  <i>[Evidenca A.2.4, Analizë Vjetore e Punës së Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës (Viti Akademik 2022-2023)] dhe [Evidenca A.2.6, Plan Pune për Zhvillimin e DESF, 2023-2024]</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**Standardi IV.1**

**Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet**





**sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ka në fokusin dhe detyrat e saj hartimin e politikave dhe strategjive për mirëfunksionimin e BNj, si dhe rekrutimin e një stafi të kualifikuar në përputhje me politikën e organizatës dhe legjislacionin në fuqi, sikurse dhe zbatimin e procedurave institucionale dhe aktet e brendshme rregullatore lidhur me punësimin e stafit.</p> <p>UniBa ndjek një politikë të hapur të punësimit dhe rekrutimit të burimeve njerëzore, mbështetur në Manualin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Rekrutimi i personelit akademik mbështetet mbi eksperiencën në mësimdhënien universitare, gradat/ titujt shkencorë dhe aktivitetin kërkimor shkencor e botues, në përputhje me politikën e organizatës dhe legjislacionin në fuqi. UniBa ka një procedurë të mirë përcaktuar për punësimin e personelit akademik. Procesi nis me evidentimin e nevojave nga njësitë bazë dhe kryesore, i cili bëhet çdo fillim semestri apo viti akademik. Kërkesat depozitohen pranë ZMBNJ, e cila publikon shpalljen për vendet vakante ku specifikohen edhe kriteret që duhet të përmbushin kandidatët për pedagogë.</p> <p>Në lidhje me këtë proces, institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike, të cilat janë pjesë e akteve të brendshme rregullatore, dhe bëhen publike në faqen zyrtare të UniBa-s, duke mundësuar kështu aksesin nga personat e interesuar.</p> <p>Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit me karakter profesional “Teknik në operacione biznesi, marketing dhe shitje”, përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit është me grada shkencore dhe tituj, konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, si edhe ka ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve ku është angazhuar. Kualifikimet dhe eksperiencat e tyre profesionale përputhen me modulën që angazhohen: <a href="https://umb.edu.al/news5146.html">https://umb.edu.al/news5146.html</a></p> <p><i>[Evidenca A.1.6, Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore]</i>  <i>[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB]</i>  <i>[Evidenca A.3.11, CV e Stafit Akademik të programit të studimit]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik efektiv i Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe aktet rregullatore të brendshme. Në fillim të vitit akademik, Rektori i Institucionit, dërgon periodikisht udhëzime në lidhje me shpërndarjen e ngarkesës mësimore, vit pas viti.</p> <p><i>[Evidenca A.1.16, Udhëzim lidhur me punën për hartimin e ngarkesës mësimore për vitin akademik 2022-2023]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>UniBa, për të gjithë periudhën e akreditimit të programit të studimit, dëshmon për një qëndrueshmëri të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p> <p><a href="https://umb.edu.al/news5146.html">https://umb.edu.al/news5146.html</a>  <a href="https://umb.edu.al/news5147.html">https://umb.edu.al/news5147.html</a></p> <p><i>[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB]</i>  <i>[Evidenca A.1.8, Format i Dosjes personale të stafit]</i></p>



<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.<sup>6</sup></p> <p>Përzgjedhja e pedagogëve që do të japin një lëndë të caktuar realizohet bazuar në ekspertizën akademike dhe kërkimore të pedagogut, si edhe përvojës në fushën e mësimdhënies. Niveli i kualifikimit të personelit akademik që angazhohet në këtë program studimi është në përputhje me natyrën dhe specifikën e programit.</p> <p><i>[Evidenca A.1.6, Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore]</i>  <i>[Evidenca A.1.8, Formati i Dosjes personale të stafit]</i>  <i>[Evidenca A.3.11, CV e Stafit Akademik të programit të studimit]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>UniBa ka angazhuar personel ndihmës mësimor shkencor për realizimin e orëve të ushtrimeve, laboratorëve, etj. Personeli administrative, akademik dhe ndihmës akademik është gjithmonë në shërbim të studentëve për të siguruar mbarëvajtjen e procesit mësimor. UniBa dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Me transferimin në kampusin e ri të UniBa në nivel fakulteti dhe institucioni ka zyra përgjegjëse, që merren me mirëmbajtjen e infrastrukturës në dispozicion të programeve, dhe sigurojnë mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mjediseve të tjera mësimore siç janë laboratorët e City Lab, që përfshijnë një shumëllojshmëri laboratorësh mësimorë si: laboratorit i sigurisë dhe emergjencave natyrore, eficientës së energjisë, ndryshimeve klimatike etj.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ.</p>	<p>Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore është njësi përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit akademik, ndihmës mësimor-kërkimor dhe administrativ, të angazhuar në nivel institucioni, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p><i>[Evidenca A.1.6, Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore]</i>  <i>[Evidenca A.1.8, Formati i Dosjes personale të stafit]</i></p> <p>Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. Për secilin personel të angazhuar në UniBa, ZMBNj mbledh dhe administron dokumentacionin, sipas formateve të miratuara paraprakisht.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>UniBa ka vënë në dispozicion personel për mentorimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, pasi programi i studimit kërkon kryerjen e praktikës profesionale pranë institucioneve të ndryshme publike ose jopublike.</p> <p>Institucioni ynë ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kompani private dhe institucione shtetërore, duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm me ta, për të garantuar akomodimin e studentëve për zhvillimin e praktikave në këto institucione. Mbikëqyrja bëhet nga anëtarët e stafit akademik të cilët ndjekin zhvillimin korrekt të praktikës profesionale në institucionin pritës dhe</p>

<sup>6</sup> <https://umb.edu.al/news5146.html>  
<https://umb.edu.al/news5147.html>

*[Handwritten signatures in blue ink]*





	<p>japin vlerësimin e tyre. Aktualisht institucioni disponon dhe zotëron të gjitha ambientet, kapacitetet dhe mjediset e nevojshme për zhvillimin e praktikës jo vetëm brenda vetes por e mundëson atë edhe në kuadër të partneritetit me Biznese, institucione shtetërore, OJF, etj., me qëllim që studentët të plotësojnë në maksimum preken e terrenit të tyre të punës duke e zhvilluar sa më të plotë e më shumë profesionale praktikën, si brenda institucionit ashtu edhe në institucionet dhe njësitë partnere. Për këtë kemi në dispozicion marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit dhe korrespondencën e vazhdueshme me partnerët në përfundim të kryerjes së praktikës nga ana e studentit <i>[Evidenca A.1.7, Paketa e Praktikës për Programet me karakter Profesional]</i>.</p>			
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve/ raportin përfundimtar të praktikës si edhe merr pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p> <p><i>[Evidenca A.1.7, Paketa e Praktikës për Programet me karakter Profesional]</i>  <i>[Evidenca A.3.9, Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit]</i>  <i>[Evidenca A.3.9.1, Përfitimi nga marrëveshjet e bashkëpunimit]</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>
<p><b>Standardi IV.2</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b></p>				
<p><b>Kriteret</b></p>		<p><b>Vlerësimi</b></p>		
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Institucioni zotëron të gjithë kushtet dhe infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e mësimdhënies, praktikës profesionale, trajnimeve dhe çdo nevojë apo kërkesë tjetër të studentëve në lidhje me ambientin. UniBa është e angazhuar për krijimin e mjediseve dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale, bazuar në profilin e punës së secilit punonjës.</p> <p>Kapacitetet infrastrukturorë të Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë, në funksion të zhvillimit të veprimtarisë akademike të programit dhe jo vetëm, janë të përshtatshme dhe sipas parametrave bashkëkohore</p> <p><i>[Evidenca A.1.39, Verifikimi i kapaciteteve pritëse të UniBa]</i>  <i>[Evidenca A.3.14, Infrastruktura akademike në funksion të programit të studimit].</i>  <i>[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 16]</i></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Të gjitha mjediset mësimore janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, të cilat garantojnë realizimin e procesit mësimor. Një ndër objektivat kryesorë strategjikë të UniBa është digjitalizimi. Në kampusin e ri të UniBa të gjithë auditorët janë të pajisur me smartboard dhe sisteme projektimi digjital, përfshirë të gjitha mjetet e tjera të nevojshme audio dhe video. Në funksion të digjitalizimit i gjithë kampusi është i mbështetur edhe me rrjet WiFi dhe pajisjet e nevojshme elektronike si PC, laptop, printera, skaner, etj., në zyrat e stafit akademik dhe atij administrative <i>[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 16]</i> dhe <i>[Evidenca A.3.14, Infrastruktura akademike në funksion të programit të studimit].</i></p>			



<p><b>Kriteri 3.</b> Labororët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Të gjitha mjediset janë të personalizuar dhe të specializuara sipas llojit dhe profilit të degëve, drejtimeve apo moduleve që zhvillohen. Secili mjedis disponon ambientin dhe mjetet e domosdoshme të zhvillimit cilësor të mësimdhënies dhe mësim nxënies konform të gjitha standardeve të kërkuara në këtë drejtim. Mjediset, në funksion të programit të studimit, ofrojnë facilitetet e nevojshme për mundësimin e aspektit praktik dhe stimulues për studentet.</p> <p><i>[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 16]</i>  <i>[Evidenca A.3.14, Infrastruktura akademike në funksion të programit të studimit]</i></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Në njërën nga godinat e kampusit në rrugën "Frang Bardhi" janë 12 salla për leksione me sipërfaqe 932.15 m<sup>2</sup> dhe 6 klasa për seminare me sipërfaqe 221.29 m<sup>2</sup>. Labororët dhe mjediset për realizimin e praktikës profesionale Sallat për praktikë profesionale janë 2 me sipërfaqe 19.46 m<sup>2</sup> dhe labororët e informatikës në dispozicion 3 me një sipërfaqe prej 148.22 m<sup>2</sup>; 25 poste në salla interneti (përbashkët) me sipërfaqe 1419.67 m<sup>2</sup>.</p> <p><i>[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 16]</i>  <i>[Evidenca A.3.14, Infrastruktura akademike në funksion të programit të studimit]</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">X</p>
<p><b>Standardi IV.3</b>  <b>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).</b></p>			
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>		
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme për të përgatitur specialistë në fushën marketingut, shitjeve dhe operacioneve të biznesit. Literatura bazë dhe ajo ndihmëse përzgjidhet me kujdes nga lektorët e lëndëve të këtij programi studimi dhe pasqyrohet në syllabuset e lëndëve të zhvilluara në këtë program studimit, të cilat përditësohen çdo fillim viti akademik duke përcaktuar literaturën më të mirë dhe më të përditësuar</p> <p>Nëse literatura e sipër cituar nuk ndodhet në Bibliotekë, përgjegjësi i Departamentit i jep mundësinë të gjithë lektorëve të programit të studimit të bëjnë kërkesë çdo fillim viti akademik për të blerë tekste të reja, në funksion të zhvillimit sa më të mbarë të procesit mësimor.</p> <p><i>[Evidenca A.2.7.1, Relacion mbi Platformën e Bibliotekës Online]</i>  <i>[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 17]</i></p> <p>Literatura e përcaktuar nga lektori i lëndës vihet në dispozicion të studentëve në shqip në Bibliotekën (fizike dhe digjitale) të UniBa dhe studentët mund ta aksesojnë atë sipas nevojave duke hapur një kartelë studenti.</p> <p>Biblioteka e UniBa është e pajisur me literaturë fizike si tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, libra apo revista shkencore në gjuhën shqipe dhe të huaj, në përputhje me natyrën e programeve të studimit.</p> <p><i>[Evidenca A.2.7, Të dhëna për infrastrukturën e bibliotekës]</i></p>		



<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Pasurimi periodik i fondit të bibliotekës sikurse dhe shtimi i aksesit në bibliotekat online janë pjesë e politikave institucionale.</p> <p>Në fillim të çdo viti akademik, secili departament propozon një listë të përditësuar me libra që duhet t'i shtohen fondit të bibliotekës fizike dhe asaj online të nevojshëm për zhvillimin e programit mësimor. Propozimi bëhet duke identifikuar nevojat e departamentit dhe duke hulumtuar mbi domosdoshmërinë që ka ekzistenca e literaturës së përditësuar në bibliotekë për studentët e programit të studimit. Për këtë vëmë në dispozicion të verifikimit një model propozimi titujsh nga departamenti <i>[Evidenca A.2.7, Të dhëna për infrastrukturën e bibliotekës]</i>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e Universitetit “Barleti” ka filluar të japë shërbim në kohën e themelimit të këtij Universiteti në vitin 2005 dhe është e konceptuar dhe e zbatuar në hapësira të ndryshme të universitetit me qëllim shërbimin dhe ofrimin e librit sa më pranë studentit.</p> <p>Në kampusin në rrugën Fran Bardhi, njërën nga godinat ka një bibliotekë me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup> me 27 vende leximi dhe në godinën tjetër një bibliotekë me sipërfaqe 27 m<sup>2</sup> dhe 18 vende leximi. Në godinën e dytë të kampusit në rrugën Fran Bardhi ka edhe në sallë leximi me sipërfaqe 95.1 m<sup>2</sup> dhe 50 vende leximi. Gjithashtu në kampusin në rrugën e Kosovarëve ka një tjetër bibliotekë me sipërfaqe 40 m<sup>2</sup> dhe me 18 vende leximi. Numri i titujve të disponueshme në bibliotekën (salla e Bibliotekes, salla Pit Stop, Holli i Triple City, dhe Holli i Universitetit) është 9,056.</p> <p><i>[Evidenca A.2.7, Të dhëna për infrastrukturën e bibliotekës]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e UniBa është e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaj, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p> <p>Fondi i titujve në bibliotekën e universitetit është 4,250, ku një pjesë e fondit të librave mbahet dhe në sallën “Pit Stop” e gjendur ngjitur me sallën e bibliotekës. Po në këtë sallë gjenden të arkivuara punimet e diplomave të studentëve, të kategorizuara sipas viteve dhe departamenteve përkatëse.</p> <p>Menaxhimi i librave të bibliotekës bëhet nëpërmjet sistemit të platformës online, i cili mundëson menaxhimin e librave sipas kategorive të ndryshme, kontrollimin me lehtësi për lëshimin/ kthimin, vonesave, humbjes apo dëmtimin e librave. Prandaj, gjykojmë se Institucioni ka krijuar kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p> <p><i>[Evidenca A.2.7, Të dhëna për infrastrukturën e bibliotekës]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.</p>	<p>Aktualisht UniBa i krijon kushtet studentëve për të aksesuar një sërë bibliotekash ndërkombëtare online, si: biblioteka digjitale EconBiz me të cilën Universiteti Barleti ka marrëveshje bashkëpunimi, ofron orientim dhe ndihmë në kërkimin e artikujve, punimeve dhe librave digjitalë, si dhe akses të plotë dhe të licensuar në internet; biblioteka digjitale JSTOR, siguron qasje në më shumë se 12 milion artikuj të revistave akademike, libra dhe burime kryesore në 75 disiplina, UniBa aktualisht ka abonim me llogarinë e bibliotekës, nëpërmjet të cilës mund të aksesojnë staffi akademik dhe studentët dhe ku është i mundur leximi online dhe ruajtja e materialeve që kërkojnë direkt nga platforma e tyre. Me këtë bibliotekë UniBa ka një marrëveshje për një periudhë 1-vjecare për ofrimin e aksesimit “të hapur” dhe</p>



	<p>të shkarkimit në të gjithë artikujt shkencorë.</p> <p>Të tjera burime në të cilat mund të gjenden artikuj, libra, revista shkencore, punime doktorale janë: Open Textbook Library (bibliotekë e hapur e teksteve shkollore, e cila është një referencë gjithëpërfshirëse ku gjenden shumë tekste shkollore nga një sërë autorësh dhe botuesish, ndër to biznesi dhe ekonomia); OpenDissertations.org (Ebsco Open Dissertation) që është një bashkëpunim midis EBSCO dhe BiblioLabs, i cili sjell një qasje inovative për zhvillimin e kërkimit të disertacioneve doktorale ku janë të përfshirë të dhëna për disertacione dhe teza nga viti 1955 deri më sot; DOAJ (Directory of Open Access Journals) që është bazë e pavarur e të dhënave që përmban mbi 16 500 revista, ku mbulojnë të gjitha fushat e shkencës, teknologjisë, mjekësisë, shkencave shoqërore, arteve dhe shkencave humane; Springer Link që u siguron hulumtuesve qasje të hapur në miliona dokumente shkencore nga revista, libra, seri, protokolle, punime referuese dhe përmbledhje shkencore; dhe Harvard Business Review, ku studentët mund të orientohen se si të hapin llogari personale me qëllim përfitimin e informacionit dhe artikujve të ndryshëm. Duhet theksuar se UniBa është në bashkëpunim të ngushtë me disa biblioteka dixhitale ndërkombëtare për abonime institucionale, dhe po planifikon të finalizojë së shpejti bashkëpunime të mëtejshme.</p> <p><i>[Evidenca A.2.7, Të dhëna për infrastrukturën e bibliotekës]</i>  <i>[Evidenca A.2.7.1, Relacion mbi Platformën e Bibliotekës Online]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka është në dispozicion të studentëve për të gjithë kohëzgjatjen e orarit zyrtar të punës së institucionit. Orari i hapjes dhe mbylljes së bibliotekës është 08.00 – 19.45. Brenda fashës orare 08.30-16.30 stafi akademik, studentët, stafi jo akademik mund të bejmë kërkesë dhe të shërbehen me libra. Brenda fashës orare 16.30-19.45 ambientet e bibliotekës mund të përdoren për studim/lexim dhe librat në sallë mund të përdoren për lexim, por nuk bëhet shërbim i librit me vete.</p> <p>Po ashtu, nëpërmjet platformës digjitale të menaxhimit të librit<sup>7</sup>, e cila i është dedikuar studentëve dhe stafit akademik të Universitetit Barleti, mund të bëhet kërkimi i titujve të librave që ndodhen në bibliotekë, kërkimi i librave elektronikë dhe punimet e diplomave, edhe kur studentët dhe stafi nuk janë fizikisht në ambientet e universitetit.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.</p>	<p>Biblioteka është në dispozicion të studentëve për të gjithë kohëzgjatjen e orarit zyrtar të punës së institucionit.</p> <p>Orari i hapjes dhe mbylljes së bibliotekës është 08.00 – 19.45. Brenda fashës orare 08.30-16.30 stafi akademik, studentët, stafi jo akademik mund të bejmë kërkesë dhe të shërbehen me libra. Brenda fashës orare 16.30-19.45 ambientet e bibliotekës mund të përdoren për studim/lexim dhe librat në sallë mund të përdoren për lexim, por nuk bëhet shërbim i librit me vete.</p> <p>Po ashtu, nëpërmjet platformës digjitale të menaxhimit të librit<sup>8</sup>, e cila i është dedikuar studentëve dhe stafit akademik të Universitetit Barleti, mund të bëhet kërkimi i titujve të librave që ndodhen në bibliotekë, kërkimi i librave elektronikë dhe punimet e diplomave, edhe kur studentët dhe stafi nuk janë fizikisht në ambientet e universitetit.</p> <p>Sikurse u përmend edhe në kriterin 2, pasurimi periodik i fondit të bibliotekës sikurse dhe shtimi i aksesit në bibliotekat online janë pjesë e politikave institucionale.</p>

<sup>7</sup> <https://umb.edu.al/biblioteka.html>

<sup>8</sup> <https://umb.edu.al/biblioteka.html>



Handwritten signatures in blue ink at the bottom of the page.

	<p>DESF në UniBa bashkëpunon ngushtësisht me përgjegjësen e bibliotekës për rritjen e cilësisë së shërbimit të bibliotekës, dhe jo vetëm. Për të inkurajuar studentët që të marrin një libër më shpesh në duar, për të apasionuarit e librit, apo për të diskutuar rreth sfidave të librit në epokën moderne, librit përballë digjitalizmit, librit dhe teknologjisë këtë vit është krijuar dhe klubi Books and Tech<sup>9</sup>, i cili ka ndërmarre aktivitete të ndryshme me qëllim rritjen e interesit rreth librave në një botë që ndryshon me ritme të shpejta teknologjike.</p> <p><i>[Evidenca A.2.7, Të dhëna për infrastrukturën e bibliotekës]</i>  <i>[Evidenca A.2.7.1, Relacion mbi Platformën e Bibliotekës Online]</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p>X</p>
<p><b>Standardi IV.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b></p>			
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>		
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni disponon një sistem të plotë menaxhimi administrativ, pranimi, informacioni, orientimi, këshillimi, mbështetjeje sociale dhe universitare. Në të bëjnë pjesë njësitë e organikës së brendshme si: sekretaria mësimore, zyra e rekrutimit dhe pranimit, dekani i studentëve, klubet studentore si dhe të gjithë stafi administrativ dhe akademik, i cili ofron në vazhdimësi informacion të rëndësishëm e të vlefshëm për studentët dhe i mbështet ata profesionalisht në çdo hap të formimit të tyre akademik, social dhe studentor. UniBa disponon platforma të menaxhimit të studenteve, siç është ajo e portalit studentor apo platforma Classroom. Portali studentor është një sistem në përdorim nga studentët që iu mundëson atyre të informohen në kohë reale lidhur me rezultatet e tyre akademike, me informacione mbi lektorët dhe të dhëna të tjera me rëndësi për ta.</p> <p>Ky zinxhir përbën një garanci dhe pikë referimi për studentët drejt hapave të rëndësishëm në karrierën profesionale. Mbështetja ndaj tyre nuk është vetëm profesionale dhe akademike por edhe emocionale dhe njerëzore, pra se si të orientohen në një treg dinamik dhe strategjik dhe se si të rrisin dhe zhvillojnë kapacitetet dhe aftësitë individuale e të lidhshme, për të spikatur sa më shpejt në profesion dhe në jetë.</p> <p><i>[Evidenca A.1.34, Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së teknologjisë së informacionit UniBa]</i></p>		
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik, si dhe partnerëve të angazhuar për realizimin e programit. Ky sistem përbëhet nga Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Sekretaria e Përgjithshme dhe Sekretariatë Mësimore, Bordet e Karrierës pranë Departamenteve, Zyra e Menaxhimit dhe Vlerësimit të Performancës, si dhe Zyra e Menaxhimit të Logjistikës dhe Operacioneve.</p> <p>Këto njësi me anë të kooperimit në kuadër të funksioneve, detyrave dhe përgjegjësie funksionale dhe organike, si dhe ndërveprimit me njëra tjetrën</p>		



<sup>9</sup> <https://umb.edu.al/news4985.html>  
<https://umb.edu.al/news5067.html>  
<https://umb.edu.al/news5014.html>



Page 45

Handwritten signatures in blue ink are present at the bottom of the page, overlapping the page number and the stamp area.

	<p>realizojnë suksesshëm të gjitha proceset, aktivitetet dhe veprimtaritë e domosdoshme të administrimit eficient të institucionit. I gjithë dokumentacioni i nevojshëm është i aksesueshëm në shared, i kategorizuar sipas njësive të ndryshme. Gjithashtu, sistemi për komunikimin e brendshëm përfshin komunikimin online me platformat e vëna në dispozicion si edhe me anë të intranetit të monitoruar nën domain të universitetit dhe komunikimi me publikun nëpërmjet website-it zyrtar, mediave sociale, etj.</p> <p><i>[Evidenca A.1.34, Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së teknologjisë së informacionit UniBa]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Ky sistem rregullon dhe sistemon veprimtarinë e proceseve të tillë si: përgatitja dhe monitorimi i orareve mësimore, kontratat e punës, formularët e matjes dhe vlerësimit të performancës, formularët dhe programi i ngarkesës mësimore, formulari i evidentimit të masave disiplinore dhe aplikimit për leje vjetore, raporte leje lindje etj. Akses i dedikuar garantohe nëpërmjet logimit me kredencialet personale, si në intranet ashtu edhe në platformat online, sipas kategorisë së përdoruesit.</p> <p><i>[Evidenca A.1.34, Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së teknologjisë së informacionit UniBa]</i> <i>[Evidenca A.1.26, Rregullore e Protokollit dhe Arkivës]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Kjo realizohet përmes komunikimit ballë për ballë, në auditor, dhe gjithashtu me anë të sistemit elektronik të komunikimit duke përdorur adresat zyrtare të e-mailit (me domain-in umb.edu.al), si për stafin ashtu edhe për studentët.</p> <p>Universiteti Barleti disponon një domain me adresa elektronike për pedagogë dhe studentë. Gjithashtu është krijuar një bazë të dhënash elektronike e centralizuar në nivel institucioni, e emërtuar Shared, e cila siguron integrimin e informacionit.</p> <p>Departamenti ka një koordinator i cili ndihmon në mbarëvajtjen e komunikimit interaktiv.</p> <p><i>[Evidenca A.2.3, Urdhri Nr.29, datë 14.10.2022 "Për emërim në detyrë të koordinatorëve të Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës]</i> <i>[Evidenca A.1.34, Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së teknologjisë së informacionit UniBa]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Vënia në funksion dhe përdorimi i sistemeve të analizuar në kriteret e mësipërme, garanton monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ, duke mundësuar raportimin dhe të dhënat për organet drejtuese dhe titullarët.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të</p>	<p>Faqet zyrtare të internetit të institucionit janë të plotësuara në kohë reale, në Shqip dhe Anglisht, dhe rifreskohen disa herë në ditë duke mbajtur të përditësuar të gjithë informacionin e duhur mbi programin e studimit, organizimin, funksionimin, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme</p>

internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.	të institucionit. Ky përditësim bëhet në Rrjetet Sociale: Facebook, Instagram, Twitter: Universiteti Barleti, Trajnime Barleti, Klubet Studentore Barleti, si dhe në web: <a href="http://www.umb.edu.al">www.umb.edu.al</a>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Institucioni, nëpërmjet Zyrës së Financës, harton raporte financiare me të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimit dhe mbi bazën e tyre bëhen parashikime për periudha afatmesme.  <i>[Evidenca A.3.8, Plani i financimit të programit të studimit]</i> <i>[Evidenca A.1.38, Burimet Financiare UniBa]</i> <i>[Evidenca A.1.38.1, Raporti financiar vjetor institucional]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Plani i financimit, sikurse dhe Raporti Financiar Vjetor, përmbajnë të dhëna të plota dhe të pasura mbi financimin e burimeve njerëzore, shpenzimeve operative, detyrimet financiare, grandet, etj. për programin e studimit. Raporti Financiar Vjetor, paraqet të dhëna mbi Strategjinë, misionin dhe objektivat, aspektet ekonomike, kurrikulumin, buxhetin sipas zërave dhe viteve, sikurse dhe kontrollin financiar.  <i>[Evidenca A.3.8, Plani i financimit të programit të studimit]</i> <i>[Evidenca A.1.38, Burimet Financiare UniBa]</i> <i>[Evidenca A.1.38.1, Raporti financiar vjetor institucional]</i> <i>[Evidenca A.1.38.2, Raport Auditimi 2022]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Mbështetur në kërkesat ligjore të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 116, Kontrolli dhe auditimi: 1. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në institucionet e arsimit të lartë dhe njësitë përbërëse të tyre realizohen nga njësitë e auditimit të brendshëm të institucionit. Krijimi dhe funksionimi i njësite të auditimit të brendshëm bëhet në përputhje me aktet e brendshme të institucionit të arsimit të lartë. 2. Kontrolli dhe auditimi i jashtëm në institucionet e arsimit të lartë kryhen nga auditues të brendshëm ose të jashtëm, të përzgjedhur nga ministria përgjegjëse për arsimin nga lista e përditësuar çdo vit nga Ministria e Financave. Në lidhje me pikën e parë Auditimi i Brendshëm i caktuar nga aktyerët e shoqërisë ka si detyrë për të vlerësuar nëse ligjet e kontrata, politikat e

*[Handwritten signatures and stamps]*



	<p>procedurat kanë gjetur zbatimin e duhur. Raporti Vjetor i Auditimit të Brendshëm i dërgohet menaxhimit të Universitetit.</p> <p>Auditimi i Jashtëm, duke filluar nga viti 2017 Pozicioni Financiar i Institucionit dhe veprimtaria financiare e tij auditohen rregullisht çdo vit nga kompania audituese "Grant Thornton" e cila është një kompani auditimi e njohur ndërkombëtarisht. Kjo kompani certifikon pasqyrat financiare të institucionit që paraqiten për palët e treta dhe organet shtetërore. Raportet e Auditimit të Jashtëm depozitohen në faqen e Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe janë lehtësisht të disponueshme për të gjitha palët e interesuara [Evidenca A.1.38.2, Raport Auditimi 2022].</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Po, në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike duke identifikuar dhe planifikuar nevojat për ndërhyrje specifike, për më shumë larmishmëri të financimit të programit dhe për një ecuri sa më rezultative të tij në të ardhmen. Referuar raporteve financiare evidentohet gjithashtu rezultati dhe efekti i financimit të programit të studimit por edhe pritshmëritë e mënyrës së financimit dhe bëhen parashikimet/planet për vijimësinë e tij me qëllim rritjen e standardeve, shoqëruar me interesim dhe përzgjedhje më të lartë të tij nga të interesuarit. Çdo vit treguesit financiarë si dhe zbatimi i buxhetit bëhen pjesë e analizës në bordin e Administrimit [Evidenca A.1.38.2, Raport Auditimi 2022].</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni zotëron plotësisht të gjitha të ardhurat e nevojshme financiare për të garantuar stabilitetin e nevojshëm dhe kapacitetet e duhura financiare për të ardhmen. Të ardhurat kryesore të institucionit janë tarifatat e studentëve si dhe të ardhura të tjera nga projekte dhe donacione. Nga pasqyrat financiare ndër vite, raportet e auditimit, opinionet dhe sugjerimet e Bordit, rezultojnë se Institucioni ka qëndrueshmëri financiare dhe kapacitetet financiare të duhura për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen. Raporti i auditimit financiar evidenton përdorimin e të ardhurave nga tarifatat e studentëve në favor të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimeve për studentët.</p> <p>[Evidenca A.3.8, Plani i financimit të programit të studimit] [Evidenca A.1.38, Burimet Financiare UniBa]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p><b>Standardi V.1</b></p> <p>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</p>
--



Handwritten signatures in blue ink, including several distinct signatures and a large, stylized signature.



Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Procesi nga pranimi i studentëve deri në diplomimin e tyre mbështetet në: legjislacionin në fuqi në Ligjin nr. 80/2015 si dhe VKM nr. 41, dt. 24.01.2018 ndryshuar me VKM nr. 879, dt. 18.12.2019, statutin e institucionit, rregulloren akademike UniBa, rregulloren e programit të studimit, burimet njerëzore dhe kapacitetet infrastrukturore. Institucioni kujdeset që të ndjekë ecurinë e studentit gjatë gjithë procesit, duke hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura përkatëse.</p> <p>Universiteti Barleti ka një strukturë të mirë organizuar për shërbimet studentore nga hyrja në dalje që drejtohen nga Zv. Rektori për Çështjet Studentore i cili drejton punën e disa zyrave si: Zyrën e Rekrutimit, Pranimin dhe Regjistrimit, Dekanin e Studentëve dhe vet-organizimi studentor dhe Zyrën e Alumnit dhe Karrierës. Detyrat dhe përgjegjësitë e secilës prej zyrave përshkruhen në rregulloren e UniBa-s.</p> <p><i>[Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti]</i>  <i>[Evidenca A.1.20, Manual Rekrutim Aplikim Regjistrim Transferim i studenteve]</i>  <i>[Evidenca A.1.21, Rregullore për Funksonimin e Sekretarisë Mësimore]</i>  <i>[Evidenca A.1.22, Rregullore e Brendshme për Transferimet 2023]</i>  <i>[Evidenca A.1.23, Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentëve pranë UniBa]</i>  <i>[Evidenca A.1.33.7, Plani i punës Zyra e Karrierës 2023 – 2024]</i>  <i>[Evidenca A.1.33.8, Plani Strategjik Alumni dhe Karriera 2020 – 2025]</i>  <i>[Evidenca A.1.33.9, Plani i punës Dekani i studenteve 2023-2024]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat nga hyrja në dalje janë transparente për të gjithë, duke garantuar barazi dhe të drejta të barabarta për kandidatët dhe studentët e programeve të studimit. Kjo përbën dhe një nga parimet e funksionimit të UniBa, përshkruar në rregulloren e institucionit, rregulloren e programit, manualin e bursave e të gjithë aktet e tjera rregullatore të UniBa-s.</p> <p><i>[Evidenca A.1.1, Statuti i Universitetit Barleti, Kreu VI]</i>  <i>[Evidenca A.1.1.1, Urdhër 360, datë 23.12.2020, Për miratimin e Statutit]</i>  <i>[Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti, Kreu IX]</i>  <i>[Evidenca A.3.3, Rregullore PP - TOBMSH, Kreu VI]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Kriteret, procedurat e pranimin<sup>10</sup> të përzgjedhjes së studentëve, si dhe kërkesat e tyre për transferim<sup>11</sup> janë lehtësisht të aksesueshme, transparente dhe publike. Çdo i interesuar mund t'i aksesojë ato si në faqen zyrtare të internetit të Universitetit<sup>12</sup>, si edhe nëpërmjet komunikimeve direkte me/në zyrat përkatëse të Institucionit dhe në aktet rregullatore të UniBa-s.</p> <p><i>[Evidenca A.1.20, Manual Rekrutim Aplikim Regjistrim Transferim i Studenteve]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimin dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së</p>	<p>Procesi i pranimin përbën kushtin paraprak të regjistrimit të studentëve të rinj në të gjitha ciklet e studimit në Universitetin "Barleti". Kriteret, <u>procedurat e regjistrimit</u> të përzgjedhjes së studentëve, si dhe kërkesat e tyre për <u>transferim</u> janë lehtësisht të aksesueshme, transparente dhe publike. Çdo i interesuar</p>


<sup>10</sup> <http://umb.edu.al/procedurat-e-aplikimit.html>

<sup>11</sup> <http://umb.edu.al/transferohu.html>

<sup>12</sup> <http://umb.edu.al/pranimet.html>



<p>kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>mund t'i aksesojë ato si në <u>faqen zyrtare të web të Universitetit</u>, edhe nëpërmjet komunikimeve direkte me/në zyrat përkatëse të Institucionit dhe në aktet rregullatore të UniBa-s.</p> <p><i>[Evidenca A.1.20, Manual Rekrutim Aplikim Regjistrim Transferim i studenteve]</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>		
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>UniBa rezervon të drejtën për të ofruar bursa të ndryshme studimi, të plota ose të pjesshme, bazuar në kriteret e përcaktuara në aktet e brendshme normative dhe në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.</p> <p>UniBa bën publike llojet e bursave të ofruara prej saj. UniBa nën drejtimin e Administratorit nëpërmjet akteve të brendshme organizon komisione ad hoc me qëllim, shqyrtimin e aplikimeve për bursa. Miratimi përfundimtar i tyre bëhet nga Bordi i Administrimit <i>[Evidenca A.1.3. Rregullore e universitetit Barleti, Neni 84]</i>.</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">X</p>
<p><b>Standardi V.2</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b></p>			
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>		
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit janë parashikuar procedurat dhe informacioni i detajuar lidhur me të gjithë procesin dhe përparimin akademik. Në rregullore parashikohen të drejtat dhe detyrat e studentëve, dokumentimi i vlerësimeve, komunikimi i vlerësimeve, zhvillimi i provimeve, e drejta për të hyrë në provim, kritere dhe procedura të vlerësimit, transferimi i studimeve, ndërprerja dhe rifillimi i studimeve etj.</p> <p>Përmes koordinatorës së departamentit dhe sekretarisë mësimore, studentët informohen në detaje lidhur me secilën prej procedurave të parashikuara. Ata mund të informohen për vlerësimet për secilën lëndë të zhvilluar gjatë gjithë vitit akademik, për numrin e krediteve të akumuluar për të kaluar nga një vit akademik në tjetrin, etj.</p> <p>Në javën e parë të pranimit në UniBa, gjatë javës së akomodimit, studentët njihen me të gjithë dokumentacionin zyrtar dhe shërbimet në funksion të tyre.</p> <p><i>[Evidenca A.3.3. Rregullore e studimeve për programin me karakter profesional TOBMSH]</i></p>		
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga</p>	<p>Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. UniBa pranon transferime të studentëve nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në</p>		



*[Handwritten signatures in blue ink]*

<p>kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>institucione të tjera të arsimit të lartë. E gjithë procedura e transferimit të studentëve dhe ekuivalentimit parashikohet në Rregulloren e Transferimeve, Rregullore e Programit të Studimit dhe në Manualin Rekrutim-Aplikim-Rregjistrim- Transferim i Studentëve, Kreu VII.</p> <p><i>[Evidenca A.1.22, Rregullore e Brendshme per Transferimet 2023]</i>  <i>[Evidenca A.3.3, Rregullore e studimeve për programin TOBMSH]</i>  <i>[Evidenca A.1.20, Manual Rekrutim Aplikim Regjistrim Transferim i Studentëve]</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit të studimit profesional 2-vjeçar “Teknik në Operacione biznesi, Marketing dhe Shitje”, janë përcaktuar kriteret dhe format e vlerësimit të dijeve të studentëve - Kreu III - Vlerësimi i studentit. Në këtë kre janë parashikuar procedurat lidhur me kriteret dhe procedura të vlerësimit, e drejta për të hyrë në provim, zhvillimi i provimeve, komunikimi i vlerësimeve dhe dokumentimi i vlerësimeve. Format e vlerësimit të dijeve janë parashikuar edhe në syllabusin e lëndës dhe paraqiten nga pedagogu i modulit tek studentët që në orën e parë të mësimit</p> <p><i>[Evidenca A.3.3. Rregullore e studimeve për programin TOBMSH]</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret e diplomimit të studentëve janë të shprehura qartë në rregulloren e programit të studimit dhe në rregulloren e UniBa.</p> <p>Në programin e studimit me karakter profesional 2-vjeçar “Teknik në Operacione biznesi, Marketing dhe Shitje”, detyrimet për diplomim konsiderohen të përfunduara pasi përmbushen sipas parashikimeve në planin mësues.</p> <p><i>[Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti]</i>  <i>[Evidenca A.3.3. Rregullore e studimeve për programin me karakter profesional TOBMSH]</i>  <i>[Evidenca A.3.4, Plani Mësues për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)]</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Në mënyrë periodike gjatë vitit dhe në fillim të çdo viti akademik, UniBa zbaton një politikë të organizuar rekrutimi të studentëve të ardhshëm duke u mbështetur në një plan vjetor aktivitetesh dhe në strategjitë e rekrutimit dhe marketingut. Aty përfshihen konferenca me maturanët, konferenca me mësuesit e karrierës nëpër gjimnaze dhe jo vetëm, eskursion tour të maturanëve në ambientet e institucionit, vizita të stafit të UniBa në shkollat e mesme duke prezantuar me detaje kriteret e pranimet në secilin program studimi, konkurset, bursat, etj. Të gjitha këto informacione gjenden edhe në Web-in zyrtar të UniBa në sektorin e Pranimet. Po ashtu, në fillim të vitit të ri akademik, UniBa zhvillon Javën e Orientimit, ku studentët e ardhshëm prezantohen me ambientet, stafin akademik dhe atë mbështetës.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>
<p><b>Standardi V.3</b></p> <p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e</p>				



Handwritten signatures in blue ink at the bottom of the page.

**pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të detajuar për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programin e studimit në kohë dhe forma të ndryshme, si p.sh.:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Në mjediset e UniBa, gjatë ditëve të pritjes me maturanët ku organizohen takime informuese, sqaruese dhe orientuese në lidhje me programin e studimit;</li> <li>2. Gjatë periudhës së regjistrimit dhe gjatë javës së parë të akomodimit, në të cilën Dekani i Fakultetit, përgjegjësi i Departamentit, koordinatori i Departamentit dhe personeli akademik bëjnë prezantimin e programit të studimit;</li> <li>3. Gjatë viteve të studimeve, koordinatori i departamentit jep orientime të nevojshme dhe të vazhdueshme për organizimin e programit të studimit.</li> </ol> <p>Për t'i shërbyer procesit sa më sipër, në lidhje me programin e studimit janë përgatitur dhe vënë në dispozicion në hollin e institucionit materiale informuese, sqaruese dhe ndërgjegjësuere, si: fletëpalosje, postera, broshura etj., si dhe materiale audio-vizive, si: spote televizive, mesazhe promovionale, etj;</p> <p>Të dhëna të detajuara për programin e studimit gjenden edhe në faqen e internetit, në hapësirën virtuale dedikuar këtij departamenti: <a href="https://umb.edu.al/program-studimi/diploma-profesionale/dp-teknik-ne-operacione-biznesi-marketing-dhe-shitje.html">https://umb.edu.al/program-studimi/diploma-profesionale/dp-teknik-ne-operacione-biznesi-marketing-dhe-shitje.html</a></p> <p>Nëpërmjet rrjetit të gjerë të shërbimeve studentore studentët kanë një jetë aktive në UniBa ku ndërthuren projektet dhe aktivitetet e iniciuara nga pedagogët, departamentet si dhe nga vetë studentët nëpërmjet klubeve studentore dhe aktiviteteve të tjera.</p> <p><i>[Evidenca A.1.33.4, Strategjia e klubeve studentore 2020-2025]</i>  <i>[Evidenca A.1.33.5, Manuali i Klubeve Studentore 2022]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Studentët e programit të studimit të studimit profesional 2-vjeçar “Teknik në Operacione biznesi, Marketing dhe Shitje”, që në fillim të vitit akademik, por edhe gjatë studimit të tyre marrin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me modulet, lëndët dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit nëpërmjet koordinatorit të departamentit dhe pedagogëve të secilit modul. Në fillim të çdo semestri atyre u vihet në dispozicion nga pedagogu i lëndës programi lëndor (syllabus), në të cilin janë specifikuar temat për çdo javë mësimore, shoqëruar me literaturën e detajuar me faqe, por edhe format e vlerësimit.</p> <p><i>[Evidenca A.3.10, Programet Lëndore të Programit të Studimit]</i>  <i>[Evidenca A.1.13, Udhëzues për metodat e mësimdhënies]</i>  <i>[Evidenca A.1.14, Politika për të mësuarit, mësimdhënien dhe cilësinë në mësimdhënie]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Me qëllim orientimin sa më efikas drejt tregut të punës, UniBa ka punuar ngushtësisht me punëdhënës dhe partnerë të ndryshëm dhe ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me ta. Janë nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione publike dhe private si etj. Në UniBa janë ngritur dhe funksionojnë Bordet e Karrierës, ku bëjnë pjesë ekspertë dhe profesionistë të fushës. Po ashtu, Dekani i Studentëve dhe drejtuesi i Zyrës së Alumnit dhe Karrierës përmes takimeve të ndryshme me studentë ofrojnë ndihmë në qartësimin e programit të studimit dhe mënyrën se si studentët mund të</p>



Handwritten signatures in blue ink at the bottom of the page.

	<p>orientojnë studimet e tyre drejt një punësimi të suksesshëm. Zyra e “Alumnit dhe Karrierës” në bashkëpunim me njësitë e tjera të Grupit Barleti (Barleti Human Capital etj.) zhvillojnë rregullisht aktivitete dhe trajnime për të afruar studentët me tregun e punës.</p> <p><i>[Evidenca A.1.33.7, Plani i punës Zyra e Karrierës 2023 – 2024]</i> <i>[Evidenca A.1.33.8, Plani Strategjik Alumni dhe Karriera 2020 – 2025]</i> <i>[Evidenca A.1.33.9, Plani i punës Dekani i studentëve 2023-2024]</i></p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Në funksion të realizimit të procesit mësimor studentëve u vihet në dispozicion nga koordinatori i departamentit, sekretaria mësimore, por edhe Dekani i Studentëve informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet. Koordinator i Departamentit, Dekani i Studentëve dhe Sekretaria Mësimore mbajnë kontakte të rregullta me studentët që ndjekin programin e studimit, nëpërmjet komunikimeve elektronike dhe portalit studentor.</p> <p>Çdo ndryshim në orar, ose ndryshim gjatë zbatimit të tij, u njoftohet studentëve nëpërmjet email-it zyrtar nga sekretaria mësimore. Çdo informacion tjetër në lidhje me procesin mësimor, kalendarin akademik dhe aktivitete të ndryshme mësimore që organizohen në UniBa, u dërgohet nga Koordinator i Departamentit dhe Dekani i Studentëve.</p>								
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Me qëllim orientimin sa më efikas drejt tregut të punës, UniBa ka punuar ngushtësisht me punëdhënës dhe partnerë të ndryshëm dhe ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>Bashkëpunim i institucionalizuar me institucione homologe, me institucione të administratës publike dhe organizata, realizon objektivin për praktikën, kërkimin, ndarjen e përvojave dhe punësimin e të diplomuarve. UniBa përkushtohet për t’i përgatitur studentët me njohuri të nevojshme për të arritur një karrierë profesionale në të ardhmen. UniBa ofron për të rinjtë që dëshirojnë të jenë të suksesshëm një mjedis optimal për të zhvilluar aftësitë e tyre në studim.</p> <p>Në UniBa prej dy vitesh janë ngritur dhe funksionojnë Bordet e Karrierës, të përbëra nga personalitete dhe profesionistë të fushës, për të përmbushur këtë qëllim.</p> <p>Po ashtu, Dekani i Studentëve dhe përfaqësuesi i Zyrës së Alumnit dhe Karrierës ndihmojnë, përmes takimeve të ndryshme në qartësimin e programeve të studimit dhe mënyrën se si studentët mund të orientojnë studimet e tyre drejt një punësimi të suksesshëm.</p> <p>Në veçanti zyra e “Alumnit dhe Karrierës”, në bashkëpunim me njësitë e tjera të Grupit Barleti (Barleti Human Capital etj.) zhvillojnë aktivitete për të afruar studentët me tregun e punës.</p> <p><i>[Evidenca A.1.33.7, Plani i punës Zyra e Karrierës 2023 – 2024]</i> <i>[Evidenca A.1.33.8, Plani Strategjik Alumni dhe Karriera 2020 - 2025]</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="608 1682 807 1832"></th> <th data-bbox="807 1682 1011 1832">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1011 1682 1209 1832">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1209 1682 1465 1832">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="608 1832 807 1977"></td> <td data-bbox="807 1832 1011 1977"></td> <td data-bbox="1011 1832 1209 1977"></td> <td data-bbox="1209 1832 1465 1977">X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						
<p><b>Standardi V.4</b> Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim,</p>									



si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>UniBa nëpërmjet Sekretarisë Mësimore dhe Zyrës së “Alumnit dhe Karrierës” disponon të dhëna të sakta në lidhje me numrin e studentëve të regjistruar në çdo vit akademik në programin e studimit profesional 2-vjeçar “Teknik në Operacione biznesi, Marketing dhe Shitje”, si dhe për numrin e të diplomuarve  <i>[Evidenca A.3.12, Tabelat përmbledhëse për RVB, Tabela 21]</i></p> <p>Institucioni disponon një bazë të dhënash të detajuara në lidhje me studentët e regjistruar në programin e studimit profesional 2-vjeçar “Teknik në Operacione biznesi, Marketing dhe Shitje”, studentët e transferuar apo ata që kanë ndërprerë studimet për një periudhë afatshkurtër si edhe ata që janë çregjistruar. Ky informacion gjendet pranë Sekretarisë Mësimore.  <i>[Evidenca A.1.21, Rregullore për Funkcionimin e Sekretarisë Mësimore]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat e studentëve menaxhohen nga Sekretaria Mësimore nëpërmjet përdorimit të sistemit të brendshëm të informacionit. Gjithashtu në funksion të studentëve është portali studentor<sup>13</sup>, platformë ku pasqyrohen të dhënat mbi notat dhe rezultatet e provimeve, datën e zhvillimit të provimit, etj. Portali studentor u mundëson studentëve të informohen në kohë reale lidhur me rezultatet e tyre akademike dhe të dhëna të tjera me rëndësi për ta. Sekretaria mësimore përpunon këto të dhëna për Dekanin dhe Përgjegjësin e Departamentit sipas kërkesës.  <i>[Evidenca A.1.34, Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së teknologjisë së informacionit UniBa]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Çdo student ka dosjen e tij, ku përmbahen të gjitha të dhënat për ecurinë e studimeve dhe rekordet e studentit. Dosjet e aplikantit verifikohen nga komisioni i ngritur nga Departamenti. Këto të dhëna gjenden në Sekretarinë Mësimore. Të dhënat e studentëve menaxhohen nëpërmjet përdorimit të infrastrukturës informatike, të përshtatur për mbajtjen e të dhënave. Gjithashtu në funksion të studentëve është edhe portali studentor, platformë ku gjenden të dhënat mbi notat dhe lëndët e dhëna provim: <a href="https://studentportal.umb.edu.al/">https://studentportal.umb.edu.al/</a>  <i>[Evidenca A.1.21, Rregullore për Funkcionimin e Sekretarisë Mësimore]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për programin e studimit realizon për çdo vit akademik një raport analitik, kur prezanton cilësinë e studentëve, rezultatet e arritura prej tyre, si dhe realizimin e objektivave të departamentit për këtë program studimi. Ky informacion përdoret për të bërë analizën vjetore të institucionit dhe paraqitet në raportin vjetor. Gjithashtu këto të dhëna janë pjesë e analizës vjetore të punës së njësive bazë për ecurinë e programeve të studimit. Pjesë e analizës vjetore janë edhe sugjerimet dhe masat që duhen marrë për përmirësimin e këtyre treguesve. Departamenti në bashkëpunim me Zyrën Alumni dhe Karriera ruajnë komunikime të shpeshta me të diplomuarit e tyre lidhur me ecurinë e tyre në tregun e punës dhe mbështetjen e mëtejshme</p>

<sup>13</sup> <https://studentportal.umb.edu.al/>



	<p>nëpërmjet kualifikimit të vazhduar apo edhe paraqitjen e mundësive për punësim.</p> <p><i>[Evidenca A.1.33.7, Plani i punës Zyra e Karrierës 2023 – 2024]</i>  <i>[Evidenca A.1.33.8, Plani Strategjik Alumni dhe Karriera 2020 – 2025]</i>  <i>[Evidenca A.2.4, Analizë Vjetore e Punës së Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës 2022-2023]</i>  <i>[Evidenca A.3.12, Tabelat përmbledhëse për RVB, Tabela 21, 23]</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X
<p><b>Standardi V.5</b></p> <p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</p>			
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>		
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Në statutin dhe në Rregulloren e Universitetit “Barleti”, parashikohet përfshirja dhe angazhimi i studentëve në organe vendimmarrëse, si dhe inkurajohet pjesëmarrja e studentëve në vendimmarrje, organizimin e lirë, dhe shprehjen e mendimit të tyre. Ndër strukturat kryesore të përfshirjes së studentëve përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Senatin Akademik;</li> <li>• Këshillin e Etikës dhe Shanseve të Barabarta;</li> <li>• Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Standardeve të Cilësisë;</li> <li>• Dekanatin e Fakultetit;</li> <li>• Këshillin / qeverinë e studentëve;</li> <li>• Mbledhjet e departamenteve, një herë në muaj të hapura për studentët.</li> </ul> <p><i>[Evidenca A.1.1, Statuti i Universitetit Barleti]</i>  <i>[Evidenca A.1.1.1, Urdhër 360, datë 23.12.2020, Për miratimin e Statutit]</i>  <i>[Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti]</i>  <i>[Evidenca A.1.19, Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë]</i>  <i>[Evidenca A.1.33.1, Politika të mbështetjes, përkrahjes për studentët dhe struktura organizative të tyre]</i>  <i>[Evidenca A.1.33.2, Rregullore e zyrave studentore dhe këshillimit të karrierës]</i>  <i>[Evidenca A.1.33.3, Rregullore Qeveria Studentore]</i>  <i>[Evidenca A.1.33.4, Strategji e Klubeve Studentore 2020-2025]</i>  <i>[Evidenca A.1.33.5, Manual i Klubeve Studentore 2022]</i>  <i>[Evidenca A.1.33.6, Të dhëna për këshillat studentorë dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese]</i></p>		
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në</p>	<p>Studentët të cilët janë të përfshirë në organet vendimmarrëse të UñiBa janë pjesë e pandarë e strukturave ku ata bëjnë pjesë. Si anëtarë të këtyre organeve, ata njoftohen të marrin pjesë dhe mendimet e tyre janë pjesë e diskutimeve në</p>		



*[Handwritten signatures in blue ink]*

<p>vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>këto organe.</p> <p>Studentët përfshihen edhe në forma dhe mënyra të ndryshme në vlerësimin e procesit akademik. Sondazhi që bëhet nga Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë dy herë në vit mbledh të dhëna për secilën lëndë dhe secilin pedagog dhe të gjithë studentët mund të japin mendimet e tyre lidhur me proceset mësimore dhe jo vetëm.</p> <p>Gjithashtu njësia ka parashikuar edhe zhvillimin e fokus grupeve me studentët apo edhe sondazhe të tjera për të mbledhur dhe vlerësuar opinionet e tyre [Evidenca A.1.9, Rregullore e Njësise së Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë].</p> <p>Këshilli studentor i cili përbëhet nga të gjithë senatorët e grupeve të studimit është organi i cili përafqëson zërin e studentëve në vendimmarrje. Përfaqësues nga ky këshill marrin pjesë edhe në mbledhjet e senatit akademik. Njëkohësisht studentët përfaqësohen me një anëtar në grupin e punës për hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm për akreditimin e programit ku ata bëjnë pjesë, apo në akreditimin institucional. Një student i këtij programi është përfshirë në këtë RVB.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit realizohet përmes pyetësorëve të studentëve. Njësia e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë, kryen anketime dy javë përpara mbarimit të çdo semestri, me secilin grup, në të gjitha programet e studimit, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Nga të dhënat e mbledhura nga anketimi me studentët dhe/ose fokus grupet dalin sugjerime për përmirësimin e programit të studimit. Rezultatet e pyetësorëve përdorën nga njësiti bazë dhe kryesore si edhe nga pedagogët përkatës për të rishikuar lëndën dhe për të përmirësuar mësimdhënien dhe të nxënë.</p> <p>[Evidenca A.1.9, Rregullore e NJZHKC-së]  [Evidenca A.1.11, Formular Vlerësimi i Studentëve për lëndën]  [Evidenca A.1.29, Raport për Vlerësimin e Cilësisë në UniBa]  [Evidenca A.1.30, Raporti Vjetor UniBa 2022-2023]</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve është një proces transparent, i cili pasqyrohet në rregulloret e UniBa, sikurse dhe në syllabusin e secilës lëndë. Dhënia e argumenteve për vlerësimin e studentëve nga pedagogu i secilës lëndë, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim nga një komision i posaçëm, janë tregues i vëmendjes që UniBa ka ndaj transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit [Evidenca A.1.3. Rregullore e universitetit Barleti, Neni 88].</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p>X</p>
<p><b>Standardi V.6</b></p> <p>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, mënxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p>				



Handwritten signatures in blue ink at the bottom of the page.



Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Njësitë e posaçme të ngritura në UniBa me qëllim informimin dhe shërbimin e studentëve janë Zyra e Pranimit, Sekretaria Mësimore, Dekani i Studentëve, Zyra e Alumni dhe Karrierës dhe Koordinatori i Departamentit.</p> <p>Këto njësi ndjekin ecurinë e studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar këshillim për çështje akademike në shërbim të procesit mësimor, si dhe ato studentore.</p> <p><i>[Evidenca A.1.21, Rregullore për Funkcionimin e Sekretarisë Mësimore]</i>  <i>[Evidenca A.1.33.2, Rregullore e zyrave studentore dhe këshillimit të karrierës]</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Studentët në UniBa mund t'i drejtohen Sekretarisë Mësimore dhe Koordinatorit të Departamentit për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> <p>Gjithashtu ata mund t'i drejtohen Dekanit të Studentëve dhe Zyrës së "Alumnit dhe Karrierës", për të marrë informacion dhe këshillim për aktivitete e shërbime mbështetëse brenda e jashtë UniBa dhe për mbarëvajtjen e jetës së tyre studentore.</p> <p><i>[Evidenca A.1.33.2, Rregullore e zyrave studentore dhe këshillimit të karrierës]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Studentët në mënyrë të vazhdueshme marrin shërbim mbështetës për të planifikuar karrierën e tyre nga njësitë e shërbimeve studentore Dekani i Studentëve dhe Zyra "Alumni dhe Karriera", të cilat bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme me departamentet, për të lehtësuar dhe ndihmuar studentët për shërbimin e këshillimit të karrierës. Gjithashtu studentët orientohen për institucionet ku mund të zhvillojnë praktikën e tyre profesionale, nëpërmjet koordinatorit të departamentit dhe pedagogut të përcaktuar për të mbikëqyrur lëndën e praktikës profesionale të parashikuar në planin mësimor të këtij programi studimi.</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Zyra "Alumni dhe Karriera" në UniBa mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe ka krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre apo vazhdimin e studimeve jo vetëm në UniBa, por edhe institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Këto të dhëna ajo i siguron bazuar në komunikimet e vazhdueshme me ta, nëpërmjet adresave të e-mail, kontaktit me telefon, pyetësorëve, adresave të rrjeteve sociale, etj.<sup>14</sup></p> <p>Çdo vit, zyra "Alumni dhe Karriera" harton plane dhe raporte vjetore në lidhje me gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar programin e studimit dhe sipas kërkesës ua vë ato në dispozicion organeve përkatëse.</p> <p><i>[Evidenca 20.1, Rregullore e Funkcionimit të zyrave në shërbim të studentëve pranë UniBa, neni 9]</i>  <i>[Evidenca A.3.12, Tabela Përmbledhëse për RVB, Tabela 23]</i>  <i>[Evidenca A.3.13, Raporte Vjetore për gjurmimin e studentëve nga Zyra</i></p>

<sup>14</sup> Linku i pyetësorit: [https://docs.google.com/forms/d/1uA3zdzmClqcAmsELYYIfKOFvb2a8rMHv\\_0TppPI00A/edit](https://docs.google.com/forms/d/1uA3zdzmClqcAmsELYYIfKOFvb2a8rMHv_0TppPI00A/edit)



	<i>Alumni dhe Karriera</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
				X
<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional në “Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

- 1) Disiplina për të cilën programi formon studentët është në rritje të vazhdueshme në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës;
- 2) Plani mësimor i programit, i përmirësuar dhe azhornuar, i cili i formon studentët me dije dhe aftësi që i bëjnë konkures për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës;
- 3) Diversifikimi i njohurive të programit, përfshirja e bazave të Menaxhimit, Marketingut Dixhital, të aplikuara në fushën e Marketingut, dhe menaxhimit të burimeve njerëzore rrisin mundësitë e punësimit të shpejtë dhe të suksesshëm nga të diplomuarit në këtë sektor në rritje në Shqipëri dhe më gjerë;
- 4) Shërbimi që i ofrohet studentit nëpërmjet këtij programi studimi, duke ndërthurur pjesën teorike dhe mbi të gjitha aplikative bëhet i krahasueshëm me standardet ndërkombëtare;
- 5) Pjesa praktike që ofron programi dhe pajisja e studentëve me njohuri të tregut dhe kërkimore-aplikative gjatë studimeve në TOBMSH vlen për tu konsideruar;
- 6) Prezenca e bursave për programin e studimit si bursa sociale, ekselence, për arritje kulturore, për arritje në mësimnxënie që ka afruar studentët drejt IAL -së sonë;
- 7) Bashkëpunimi me institute, pjesë e Grupit Barleti, që zbatojnë projekte të ndryshme në kuadër të të cilit organizohen dhe marketohen aktivitetet që ju krijojnë studentëve mundësi përfshirjeje;
- 8) Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione partnere ku studentët mund të kryejnë praktikën mësimore.

**Pika të dobta:**

- 1) Mungesa e një programi të vijimesisë për azhornimin post program.

**Rekomandime:**

- 1) Shtimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me IAL të huaja për eksperiencë që ndihmojnë kualifikimin e stafit të ri;



Handwritten signatures in blue ink at the bottom of the page.

- 2) Mbështetja për zhvillimin e kurrikulave me inputet nga profesionistë të fushave që janë përfshirë në Bordin e Karrierës;
- 3) Mundësia për t'u thithur nga tregu i punës të studentëve të programit, prej shumëllojshmërisë së njohurive që merr studenti gjatë viteve të studimit.

**Evaluation's conclusions for the professional study program in "Technician in Business Operations, Marketing and Sales"**

**Strengths and affirmations**

- 1) The discipline for which the program trains students is constantly growing in the national and international labor market;
- 2) The curriculum of the program, is improved and updated, which forms students with knowledge and skills that make them competitive for the national and international labor market;
- 3) The diversification of program knowledge, including subjects such as "Basics of Management", "Digital Marketing", applied in the field of marketing and human resources management, increase the possibilities of quick and successful employment by graduates in this growing sector in Albania and beyond;
- 4) The service offered to the student through this study program, combining the theoretical part and, above all, the application part, becomes comparable to international standards;
- 5) The practical part offered by the program and equipping students with market and research-application knowledge during studies at TBOMS is worth considering;
- 6) The presence of scholarships for the study program such as social scholarships, excellence, for cultural achievements, for achievements in learning that has brought students closer to our HEI;
- 7) Cooperation with institutes, part of the Barleti Group, that implement various projects within which activities are organized and marketed that create opportunities for students to get involved;
- 8) Cooperation agreements with partner institutions, where students can complete teaching practice.

**Weaknesses**

- 1) Lack of a follow-up program for post-program updating.

**Recommendations**

- 1) Increase of cooperation agreements with foreign HEIs for experiences that help the qualification of new staff;
- 2) Support for curriculum development with input from professionals in the fields that are included in the Career Board;
- 3) The opportunity to be absorbed by the job market of the students of the program, from the variety of knowledge that the students receive during the years of study program.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X



*[Handwritten signatures in blue ink]*

## **Lista e dokumenteve bazë për procesin e akreditimit të programeve të studimit**

Lista e mëposhtme është dokumentacioni i detyrueshëm që institucionet duhet të dorëzojnë së bashku me RVB në kuadër të akreditimit të programeve të studimit. Nuk është e thënë që çdo pikë e mëposhtme duhet të jetë një dokument i veçantë, por në një dokument mund të përmblihen disa nga të dhënat e kërkuara. Në rastin e programeve të ciklit të dytë (Master i Shkencave) dhe të ciklit të tretë (Specializim Afatgjatë dhe Doktoratë) i gjithë ky dokumentacion duhet të jetë në gjuhën shqip dhe angleze ashtu si dhe RVB. Në cdo rast bazohuni në Manualin për *“Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit”*

### **DOSJA A1**

Evidenca A.1.1, Statuti i Universitetit Barleti.

Evidenca A.1.1.1, Urdhër 360, datë 23.12.2020, Për miratimin e Statutit.

Evidenca A.1.2, Vendim Senati Nr.24 date 17.10.2022 Për miratim ndryshimi i organigramës së UniBa

Evidenca A.1.2.1, MAS - Dërgohet për zbatim urdhri nr. 78\_Miratimi i nje ndryshimi ne Statutin UniBa

Evidenca A.1.2.2, Urdhër i MASR për Riorganizimin Institucional të SHLUJ “Universiteti Marin Barleti” në Universiteti “Barleti”.

Evidenca A.1.3, Rregullore e Universitetit Barleti.

Evidenca A.1.4, Strategjia e zhvillimit Institucional 2020-2030.

Evidenca A.1.5, Kodi i Etikës i UniBa

Evidenca A.1.5.1, Vendim Nr. 34, datë 24.11.2022 “Për miratimin e përbërjes së Këshillit të Etikës”

Evidenca A.1.6, Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Evidenca A.1.6.1, Lista e Stafit Akademik me Kohë të Plotë, Vendim Rektorati me Prot.1044, datë 1.10.2023, për V.A. 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024]

Evidenca A.1.7, Paketa e Praktikës për Programet Profesionale.

Evidenca A.1.8, Formati i Dosjes personale të stafit.

Evidenca A.1.9, Rregullore e Njësise së Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë.

Evidenca A.1.10, Formular vlerësimi të mësimdhënies kolegë me kolegë.

Evidenca A.1.11, Formular vlerësimi i studenteve për lenden.

Evidenca A.1.12, Strategjia e ndërkombetarizimit.

Evidenca A.1.13, Udhëzues për metodat e mësimdhënies.

Evidenca A.1.14, Politika për të mesuarit, mesimdhënien dhe cilësinë në mesimdhënie.

Evidenca A.1.15, Format i Raportimit të Punës Semestrare.

Evidenca A.1.16, Udhezim lidhur me punen për hartimin e ngarkesës mesimore për vitin akademik 2022-2023.

Evidenca A.1.17, Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës.



Evidenca A.1.18, Manuali i hartimit, riorganizimit, mbylljes dhe vlerësimit të programeve të studimit.  
Evidenca A.1.19, Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë.  
Evidenca A.1.19.1, Vendim Nr. 46, datë 24.11.2023 "Për miratimin e përbërjes së Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë në UniBa  
Evidenca A.1.20, Manual Rekrutim Aplikim Regjistrim Transferim i studenteve  
Evidenca A.1.21, Rregullore per Funksonimin e Sekretarise Mesimore.  
Evidenca A.1.22, Rregullore e Brendshme per Transferimet 2023.  
Evidenca A.1.23, Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentëve pranë UniBa.  
Evidenca A.1.24, Vendim Nr. 571 dt 12.08.2005 - Dhenie leje per hapje te institucionit.  
Evidenca A.1.25, Prot. 71 (Dt. 20.01.2022) ASCAL - Percillet vendimi i Bordit te Akreditimit.  
Evidenca A.1.26, Rregullore e Protokollit dhe Arkivës.  
Evidenca A.1.27, Manuali i Cilesise.  
Evidenca A.1.28, Plan Pune NJZHKC.  
Evidenca A.1.29, Raport per Vleresimin e Cilesine ne UniBa.  
Evidenca A.1.30, Raporti Vjetor UniBa 2022-2023.  
Evidenca A.1.31, Prot. 431 (Dt. 27.03.2023) MAS - Dergohet pergjigja per Kodifikimin e programeve.  
Evidenca A.1.32, Formulari për transparencë të vlerësimit studentëve.  
Evidenca A.1.33.1, Politika të mbështetjes, përkrahjes për studentët dhe struktura organizative të tyre.  
Evidenca A.1.33.2, Rregullore e zyrave studentore dhe keshillimit te karrieres.  
Evidenca A.1.33.3, Rregullore Qeveria Studentore.  
Evidenca A.1.33.4, Strategjia e klubeve studentore 2020-2025.  
Evidenca A.1.33.5, Manuali i Klubeve Studentore 2022.  
Evidenca A.1.33.6, Të dhëna për këshillat studentorë dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese.  
Evidenca A.1.33.7, Plani i punes Zyra e Karrierës 2023 - 2024.  
Evidenca A.1.33.8, Plani Strategjik Alumni dhe Karriera 2020 - 2025.  
Evidenca A.1.33.9, Plani i punes Dekani i studenteve 2023-2024.  
Evidenca A.1.34, Udhëzues për përdorimin e Infrastrukturës së teknologjisë së informacionit UniBa.  
Evidenca A.1.35, Të dhëna mbi MoU, mobilitetin e stafit dhe studentëve në kuadër të programit Erasmus +.  
Evidenca A.1.36, Lista e konferencave, trajnimeve dhe ëorkshopeve.  
Evidenca A.1.37, Promovim i shembujve te praktikave te mira.  
Evidenca A.1.38, Burimet Financiare UniBa  
Evidenca A.1.38.1, Raporti financiar vjetor institucional  
Evidenca A.1.38.2, Raport Auditimi 2022  
Evidenca A.1.39, Verifikimi i kapaciteteve pritëse të UniBa

## DOSJA A2

Evidenca A.2.1, Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë  
Evidenca A.2.1.1, Mendimi i Dekanit  
Evidenca A.2.1.2, Urdhër i Rektorit Nr.48, datë 08.01.2024 "Për ngritjen e GVB" dhe ndryshime  
Evidenca A.2.1.3, Plan pune Grupi i Vlerësimit të Brendshëm  
Evidenca A.2.2, Rregullore e Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës  
Evidenca A.2.2.1, Vendimi Senatit Akademik Nr. 44, datë 24.11.2023 "Për miratimin e ndryshimit të nenit 6 të rregulloreve të departamenteve të Universitetit "Barleti"  
Evidenca A.2.3, Vendim i emërimit në detyrë të koordinatorit të DESF  
Evidenca A.2.4, Analiza vjetore e departamentit për vitin akademik, 2022-2023  
Evidenca A.2.5, Raport vjetor per kërkimin shkencor ne DESF, 2022-2023



Four blue ink signatures are present at the bottom of the page, spanning across the footer area.

Evidenca A.2.6, Plan pune per zhvillimin e DESF, 2023-2024  
Evidenca A.2.7, Të dhëna për infrastrukturën e bibliotekës  
Evidenca A.2.7.1, Relacion mbi Platformën e Bibliotekes Online

### DOSJA A3

Evidenca A.3.1, Licensimi i programit TOBMSH me Urdhër 568, dt. 12.9.2018.  
Evidenca A.3.2, Akreditimi për herë të parë me Vendim të Bordit të Akreditimit, Nr. 54, datë 09.09.2022  
Evidenca A.3.3, Rregullore e studimeve për programin e studimit TOBMSH  
Evidenca A.3.4, Plani Mësimor për programin e studimit (i ndryshuar në masën 20%)  
Evidenca A.3.5, Studimi periodik i tregut të punës TOBMSH  
Evidenca A.3.6, Strategjia e zhvillimit të programit të studimit  
Evidenca A.3.7, Formatit i diplomës TOBMSH  
Evidenca A.3.7.1, Urdhëri i MAS  
Evidenca A.3.7.2, Vërtetim nga QSHA për dokumentin që shoqëron diplomën  
Evidenca A.3.8, Plani i financimit të programit të studimit  
Evidenca A.3.9, Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit  
Evidenca A.3.9.1, Përfitimi nga marrëveshjet e bashkëpunimit  
Evidenca A.3.10, Programet Lëndore të Programit të Studimit  
Evidenca A.3.11, CV e Stafit Akademik të programit të studimit  
Evidenca A.3.12, Tabela Permbledhese per RVB  
Evidenca A.3.13, Vendim Rektorati, Nr. 94 dt. 12.02.2021 “Për miratimin e formatit të provimeve, etj”  
Evidenca A.3.14. Infrastruktura akademike në funksion të programit të studimit



*[Handwritten signatures in blue ink]*